



Akademia e Kosovës për Siguri Publike
Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost/Kosovo Academy for Public Safety

Divizioni për Sigurimin e Cilësisë
Odeljenje za Osiguranje Kvaliteta/Division for Quality Assurance

Raport i përgjithshëm vjetor i vlerësimit të trajnimeve për vitin 2025



Përmbajtja

Lista e shkurtesave	3
Hyrja	4
Komisioni për Sigurimin e Cilësisë - KSC	5
Divizioni për Sigurimin e Cilësisë - DSC.....	5
Realizimi i pyetësorëve	5
Të gjeturat e përgjithshme	6
Analizë e përgjithshme e impaktit të trajnimeve për vitin 2025.....	9
Analiza e impaktit në rrafshin individual tek zyrtarët e sigurisë publike	9
Analiza e impaktit në rrafshin institucional të ISP-ve	10
Të gjeturat sipas kategorizimit të trajnimeve	11
Trajnimet Profesionale.....	12
Trajnimi profesional “Zyrtar Korrektues”	13
Trajnimet Themelore	18
Trajnimet e Avancuara.....	22
Trajnimet për Instruktor	25
Trajnime tjera.....	27
Të gjeturat sipas trajnimeve për ISP	29
Policia e Kosovës.....	30
Shërbimi Korrektues i Kosovës	35
Shërbimi Sprovues i Kosovës	36
Inspektorati Policor i Kosovës	36
Dogana e Kosovës.....	37
Agjencia e Menaxhimit Emergjent	37
Të gjeturat sipas trajnimeve të ofruara nga Partnerët Ndërkombëtar	38
ICITAP.....	38
OSBE	38
Trajnimet e përbashkëta	40
Komentet e përmbledhura.....	42
Rekomandimet e përmbledhura	43

Lista e shkurtesave

AKSP: Akademia e Kosovës për Siguri Publike

ISP: Institucionet e Sigurisë Publike

PK: Policia e Kosovës

IPK: Inspektorati Policor i Kosovës

AME: Agjencia e Menaxhimit Emergjent

SHKK: Shërbimi Korrektues i Kosovës

SHSK: Shërbimi Sprovues i Kosovës

DK: Doganat e Kosovës

OSBE: Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

ICITAP: Programi Ndërkombëtar i Asistencës për Trajnimin e Hetimeve Kriminale

IADLEST: Asociacioni Ndërkombëtar i Drejtorëve të Zbatuesve të Ligjit, Trajnimet dhe Standardet

MASHT: Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë

AKK: Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve

KAAPRr: Këshilli për Arsimin dhe Aftësimin Profesional dhe për të Rritur

KKK: Korniza Kombëtare e Kualifikimeve

KEK: Korniza Evropiane e Kualifikimeve

IAAP: Institucion i Arsimit dhe Aftësimit Profesional

DTPA: Departamenti i Trajnimeve dhe Përkrahjes Arsimore

DT: Divizioni i Trajnimeve

DSHS: Divizioni i Shërbimeve Studentore

DSC: Divizioni për Sigurim të Cilësisë

ECVET: Sistemi Evropian i Kredive për Aftësim dhe Arsim Profesional

Hyrja

Akademia e Kosovës për Siguri Publike (në tekstin e mëtejme Akademia) është institucion i formuar me Ligjin nr. 04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, përgjegjës për ofrimin e trajnimeve dhe arsimit të lartë, zbatimin e politikave dhe strategjive të trajnimit, arsimit të lartë si dhe zhvillimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë publike. Në kuadër të strukturës organizative të Akademisë, si shtyllë kryesor e saj funksionon Departamenti për Trajnime dhe Përkrahje Arsimore me divizionet përbërëse të cilat kanë mision ofrimin dhe koordinimin e trajnimeve, zhvillimin e kurrikulave të programeve trajnuese si dhe ofrimin e shërbimeve për vijues në kuadër të trajnimeve që ofrohen në Akademi.

Siq edhe është e përcaktuar me ligj e Akademisë ofron programe trajnuese në fushën e sigurisë publike. Akademia ofron trajnime për të gjitha institucionet e sigurisë publike por pa u kufizuar vetëm në:

- *Policinë e Kosovës;*
- *Shërbimin Korrektues;*
- *Shërbimin Sprovues;*
- *Doganën e Kosovës;*
- *Agjencinë e Menaxhimit Emergjent;*
- *Inspektoratin Policor të Kosovës;*

Trajnimet në Akademi - Krahas aprovimit të Ligjit të Akademisë-së në dhjetor të vitit 2011, Komisioni Evropian ka aprovuar dhe financuar Projektin e Binjakëzimit me titull: “*Përkrahja e mëtejme e arsimit të sigurisë publike në Kosovë*” implementuar nga Finlanda dhe Estonia. Përmes projektit të binjakëzimi u bë e mundur krijimi dhe aprovimi i standardeve të profesionit në përputhje të plotë me Kornizën Kombëtare të Kualifikimit - KKK, e cila i hapi rrugën akreditimit institucional të Akademisë si Institucion ofrues i Arsimit dhe Aftësimit Profesional- IAAP me trajnime profesionale të validuara.

Sigurimi i cilësisë në Akademi - është pjesë e zhvillimit të vazhdueshëm për të gjitha proceset dhe aktivitetet në Akademi. Sistemi i zbatuar i cilësisë jep një pasqyrë të parimeve të menaxhimit të cilësisë në Akademi dhe tregon se si ato parime mund ta përbëjnë bazën për përmirësimin e performancës dhe përsosjes organizative.

Parimi i përmirësimit të vazhdueshëm është parimi kryesor dhe pjesë e vizionit të Akademisë. Në këtë frymë janë krijuar pyetësor në cilësinë e mekanizmave matës dhe përmirësues në fushën e trajnimeve duke e vendosur pjesëmarrësin në qendër.

Përgjatë vitit 2025, në vazhden e aktiviteteve për të përmirësuar cilësinë brenda mandatit të Akademisë, DSC-ja ka realizuar vlerësimin e të gjitha trajnimeve me kompetencë në kuadër të Akademisë. I gjithë procesi ka qenë transparent, dhe të gjithë pyetësorët kanë qenë anonim duke respektuar kështu dinjitetin e secilit respondent dhe duke ruajtur kredibilitetin dhe prestigjin e institucionit.

Komisioni për Sigurimin e Cilësisë - KSC

Komisioni për Sigurimin e Cilësisë Komisioni për Sigurimin e Cilësisë është organ këshillëdhënës dhe koordinues përgjegjës për zhvillimin, zbatimin dhe monitorimin e sistemit të sigurimit të cilësisë në Akademi, në përputhje me aktet normative në fuqi dhe standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurimit të cilësisë. Komisioni ka përcaktuar standardet e sigurimit të cilësisë në kuadër të dokumentit Standardet e Brendshme të Cilësisë, duke siguruar harmonizimin e tyre me kërkesat e akreditimit. Në këtë kuadër, Komisioni gjatë vitit 2025 ka hartuar Draft Rregulloren për Sigurimin e cilësisë, hartimin dhe miratimin e Standardeve të brendshme të sigurimit të cilësisë në Akademi, duke unifikuar standardet e AKA, AKK dhe IADLEST, po ashtu ka hartuar edhe Politikat implementuese të modelit Kirckpatrick. Komisioni ka shqyrtuar raportet përmbledhëse vlerësuese, duke garantuar transparencë, objektivitet dhe përputhshmëri me standardet e sigurimit të cilësisë. Në të njëjtën kohë, Komisioni ka promovuar dhe zhvilluar kulturën e cilësisë brenda institucionit, duke inkurajuar përfshirjen aktive të stafit akademik, trajnues, administrativ dhe vijues në proceset e sigurimit të cilësisë.

Divizioni për Sigurimin e Cilësisë - DSC

Divizioni për Sigurimin e Cilësisë është një divizioni i cili në veprim është i pavarur dhe funksionon nën Zyrën e Drejtorit të përgjithshëm të Akademisë dhe raporton direkt tek Drejtori i Përgjithshëm i Akademisë. DSC angazhohet në rritjen e cilësisë në Akademi duke zbatuar të gjitha politikat institucionale dhe instrumentet matës të cilësisë të aprovuar në doracakun e cilësisë i cili rishikohet në baza të rregullta periodike konform ndryshimeve të reja dhe azhurnimeve të reja akterët relevant për të cilat DSC ofron raportet vlerësuese. DSC harton raporte që përmbajnë gjetje dhe rekomandime për secilin pyetësor të realizuar të cilët i dërgon te Drejtori i përgjithshëm i Akademisë, Drejtori i DTPA-së, Koordinatorëve të ISP-ve dhe akterëve relevant me qëllim të planifikimit të zhvillimit të mëtutjeshëm të fushës së trajnimeve.

Realizimi i pyetësorëve

DSC bazuar në mandatin e saj dhe dokumenteve strategjike e vjetor të cilat i definojnë qartë detyrat dhe përgjegjësitë e DSC në formë të vazhdueshme ka zhvilluar matje dhe vlerësime

përmes pyetësorëve-formularëve të vlerësimit dhe të njëjtat i ka adresuar tek kanalet zyrtare duke zhvilluar pastaj edhe takime me përgjegjësitë/koordinatorët e trajnimeve për analizimin e të dhënave të fituara nga informatat kthyesë të pranuar nga pjesëmarrësit në trajnime përgjatë vitit 2025.

Pyetësorët kanë qenë anonim dhe të formatit elektronik të adresuar përmes platformës së domenit dsc.aksp@aksp-ks.org tek e-mail adresa e pjesëmarrësve e cila njëherësh është e ndërlidhur me përpunimin e të dhënave elektronike duke shfrytëzuar sistemet e licencuara.

Vijuesit janë përgjigjur përmes sistemit elektronik dhe atij fizik (në trajnime në terren) i cili në kuadër të një pyetësorit për vlerësimin e trajnimit në fjalë. Pyetësi përmban 33 pyetje nga fusha e vlerësimit të mësimnxënijes, materialit mësimor, pjesës praktike, vlerësimin e trajnuesit/instruktorit, vlerësimin e mjeteve lehtësuese në dispozicion përgjatë trajnimit si dhe shërbimeve të ofruara përgjatë trajnimit. Në kuadër të pyetësorit janë inkuadruar edhe pjesa e analizës së nevojave për trajnim. Përshtypjet dhe komentet pas secilit seksion.


Të gjeturat e përgjithshme

Akademia bazuar në planin vjetor të trajnimeve për vitin 2025 , në prezantimin e nevojave të ISP-ve për trajnimin e stafit, ka paraqitur dhe aprovuar planin e trajnimeve dhe të njëjtin ka implementuar në kuadër të politikave strategjike të ISP-ve në përputhje me kërkesat dhe nevojat e ngritjes së kapaciteteve të sigurisë publike.

DSC ka analizuar raportet vjetore të trajnimeve të realizuara e të matura dhe paraqet këto të gjetura si në vijim për trajnimet e realizuara sipas planit të trajnimeve për vitin 2025.

Plani i trajnimeve për vitin 2025	Planifikuara		Realizuara			
	Numri i trajnimeve të planifikuara	Numri i vijuesve të planifikuar	Numri i trajnimeve të realizuara	Numri i vijuesve që kanë ndjekur trajnimet	% trajnime	% vijues
Policia e Kosovës	22	1279	66	1698	300.00%	132.76%
Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave	17	412	9	149	52.94%	36.17%
Inspektorati Policor i Kosovës	4	60	0	0	0.00%	0.00%
Shërbimi Korrektues i Kosovës	16	300	7	165	43.75%	55.00%
Shërbimi Sprovues i Kosovës	3	45	0	0	0.00%	0.00%
Dogana e Kosovës	10	198	7	176	70.00%	88.89%
OSBE	6	110	4	90	66.67%	81.82%
Trajnime të përbashkëta	13	260	14	278	107.69%	106.92%
Gjithsej	91	2664	107	2556	117.58%	95.95%

Po ashtu, nëse i shtojmë këtu edhe trajnimin e paplanifikuar nga Agjencia Suedeze e Kontigjencave Civile me 13 pjesëmarrës, numri i përgjithshëm kalon në **108 trajnime ose 118.68% trajnime të realizuara**, të cilat tregojnë që Akademia ka tejkaluar vlerën e trendeve vjetore të trajnime të realizuara nga një mesatare prej 70% realizim, në 118% ose 48% me lart se e pritura bazuar në lëvizjet, planifikimet e aspektit strategjik të ISP-ve përgjatë viteve në fushën e trajnimeve.



Akademia ka planifikuar 91 trajnime sipas planit vjetor të trajnimeve për vitin 2025, ndërsa ka realizuar 108 trajnime ose ka tejkaluar vlerën mesatare të realizimit nga 70% në 118.68 % trajnime të realizuara.

Nga totali prej 108 trajnimeve të realizuara nga plani vjetor i trajnimeve, neve në kuadër të politikave vlerësuese për vlerësimin e trajnimeve që ofrojnë kompetencë kemi vlerësuar 89 trajnime të realizuara për vitin 2025, me nivelin e arritur të kënaqshmërisë prej 87.1% ose notë mesatare prej 4.35.

Po ashtu në kohë simultante kemi vlerësuar edhe trajnimin profesional:

- Trajnimi profesional “Zyrtar Korrektues” gjenerata e 45 me gjithsejtë 111 kadetë.
- Trajnimi profesional “Zyrtar Doganor”- grupi 01 me gjithsejtë 57 kadetë.
- Trajnimi profesional “Zyrtar Doganor”- grupi 02 me gjithsejtë 51 kadetë
- Trajnimi profesional “Zjarrfikës” me gjithsejtë 21 kadetë (Trajnimi vazhdon deri me 22.01.

2026)

Ajo çka e karakterizon vitin 2025 është fakti se, përkundër planifikimeve të trajnimeve dhe deklarimeve në numër të pjesëmarrësve në trajnime, kemi evidentuar tejkalim të numrit të deklaruar të pjesëmarrësve sidomos tek trajnimet e ofruara për Policinë e Kosovës të cilat tejkalojnë vlerën e deklarimit të përgjithshëm me 200% më tepër se të planifikuar për vitin 2025. Kjo njëherësh e ka vështirësuar implementimin e trajnimeve tjera në mungesë të hapësirave akomoduese, hapësirave trajnuese dhe në stërngarkim të stafit mësimdhënës/trajner/instruktor për vitin 2025. Kjo formë e ngarkesës ka prekur edhe aspektin e balancimit të trajnimeve dhe mundësive për ISP-tjera, si dhe testuar edhe aspektin financiar të vetë Akademisë në përmbushjen e kërkesave për realizimin e planit të trajnimeve për vitin 2025.

Në anën tjetër, të gjitha të gjeturat të cilat janë ofruar nga përgjigjet e pjesëmarrësve/vijuesve kanë qenë të dhëna të sinqerta të ofruara në vlerësim. Komentet dhe propozimet e tyre kanë treguar se pjesëmarrësit në trajnime janë pjesa thelbësore në kontributin e tyre në përmirësimin e vazhdueshëm në kuadër të proceseve në Akademi. Raportet individuale për secilin trajnim janë adresuar në kohë reale duke e përcjellë edhe me takime analizuese me koordinatorët e trajnimeve për hapat e më tutjeshëm.

Për të ofruar të dhëna më të detajuara, më poshtë do gjeni të gjeturat e ndara në raportin e përgjithshëm të vlerësimit të trajnimeve për vitin 2025 të ndarë sipas kategorizimit të trajnimeve në Akademi si dhe sipas ISP-ve për të cilat është ofruar trajnimi. Ky raport njëherësh shprehë statistikën e përgjithshme dhe rekomandimet që dalin nga tërësia e informatave kthyesë në nivel të trajnimeve.

Analizë e përgjithshme e impaktit të trajnimeve për vitin 2025

Të dhënat e paraqitura dëshmojnë se planifikimi dhe realizimi i trajnimeve për vitin 2025 ka qenë i orientuar drejt zhvillimit të kapaciteteve njerëzore dhe forcimit të funksionimit institucional të Institucioneve të Sigurisë Publike (ISP). Qasja e bazuar në analiza të nevojave për trajnim, si dhe diferencimi i niveleve të trajnimit (themelor, i avancuar dhe instruktor), ka krijuar një sistem të qëndrueshëm të ngritjes profesionale dhe transferimit të dijes.

Analiza e impaktit në rrafshin individual tek zyrtarët e sigurisë publike

Në rrafshin individual, impakti i trajnimeve reflektohet drejtpërdrejt në rritjen e kompetencave profesionale, specializimin e stafit dhe ndërtimin e kapaciteteve të reja për mësimdhënie dhe trajnim të brendshëm.

- Pajisja e **240 zyrtarëve të rinj** me kompetencë profesionale për ushtrimin e detyrës së zyrtarit të sigurisë publike paraqet një kontribut të drejtpërdrejtë në rritjen e kapaciteteve operative të ISP-ve. Ky grup përfaqëson burim të ri njerëzor të trajnuar sipas standardeve profesionale, duke ndikuar në përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve të sigurisë publike.
- Trajnimi i **1193 zyrtarëve në nivel themelor** ka ndikuar në standardizimin e njohurive bazë profesionale dhe në krijimin e një niveli të përbashkët kompetencash ndërmjet zyrtarëve të profileve të ndryshme. Ky nivel trajnimi ka shërbyer si bazë për përmirësimin e performancës individuale, rritjen e sigurisë në veprim dhe uljen e gabimeve profesionale gjatë ushtrimit të detyrës.
- Trajnimet e avancuara, nga të cilat kanë përfituar **677 zyrtarë**, kanë prodhuar një impakt të rëndësishëm në thellimin e ekspertizës profesionale dhe në profilizimin e ngushtë të zyrtarëve sipas nevojave specifike të dikasterëve përkatës. Ky nivel trajnimi ka rritur cilësinë e vendimmarrjes, efikasitetin operativ dhe aftësinë për përballimin e situatave komplekse në fushat përkatëse të veprimit.
- Avancimi i **91 zyrtarëve në rolin e instruktorëve** paraqet një nga impaktet më të qëndrueshme në rrafshin individual. Ky proces jo vetëm që vlerëson përvojën dhe profesionalizmin e zyrtarëve, por krijon edhe kapacitete të brendshme për bartjen e dijes, zvogëlimin e varësisë nga trajnimet e jashtme dhe ndërtimin e një kulture të vazhdueshme të të nxënit brenda ISP-ve.

Në tërësi, **impakti individual i trajnimeve për vitin 2025 vlerësohet si i lartë**, pasi ka ndikuar në rritjen e kompetencave, motivimit profesional dhe gatishmërisë operationale të zyrtarëve të

sigurisë publike.

Analiza e impaktit në rrafshin institucional të ISP-ve

Në rrafshin institucional, trajnimi ka funksionuar si mekanizëm kyç për forcimin e kapaciteteve organizative, përmirësimin e koordinimit ndërinstitucional dhe rritjen e performancës së përgjithshme të ISP-ve.


- **Policia e Kosovës**, përmes realizimit të **66 trajnimeve me 1698 zyrtarë policor të trajnuar**, ka përfituar ndjeshëm në aspektin e rritjes së profesionalizmit dhe gatishmërisë operative. Profilizimi i trajnimeve sipas analizës së nevojave ka garantuar që përmbajtja e tyre të jetë relevante, e aplikueshme dhe e orientuar drejt sfidave reale të sigurisë. Kjo ka ndikuar në përmirësimin e reagimit institucional, menaxhimin më efektiv të situatave të sigurisë dhe rritjen e besimit publik.
- **Në Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave**, realizimi i **9 trajnimeve me 149 zyrtarë të trajnuar** ka përforcuar kapacitetet për parandalim, reagim dhe menaxhim të emergjencave. Trajnimet kanë kontribuar në rritjen e koordinimit të brendshëm dhe ndërinstitucional, si dhe në përmirësimin e gatishmërisë për përballimin e situatave emergjente komplekse.
- **Shërbimi Korrektues i Kosovës**, përmes **7 trajnimeve me 165 zyrtarë korrektues të trajnuar**, ka përmirësuar standardet profesionale në menaxhimin e institucioneve korrektuese, sigurinë e brendshme dhe trajtimin profesional. Këto trajnime kanë ndikuar në rritjen e disiplinës institucionale dhe në përmirësimin e kushteve të sigurisë dhe menaxhimit.
- **Trajnimet e përbashkëta**, përmes **14 trajnimeve të realizuara janë trajnuar 278 zyrtarë nga dikastere të ndryshme**, dhe kanë pasur një impakt të veçantë në forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional. Këto trajnime kanë kontribuar në ndërtimin e një qasjeje të përbashkët ndaj çështjeve të sigurisë publike, në harmonizimin e procedurave dhe në rritjen e efikasitetit të veprimit të përbashkët në situata që kërkojnë koordinim ndërinstitucional.

Impakti i trajnimeve për vitin 2025 vlerësohet si pozitiv dhe i qëndrueshëm, si në rrafshin individual ashtu edhe në atë institucional. Trajnimet kanë ndikuar drejtpërdrejt në ngritjen e kapaciteteve profesionale të zyrtarëve, forcimin e strukturave institucionale dhe përmirësimin e performancës së përgjithshme të ISP-ve. Ky rezultat dëshmon rëndësinë e vazhdimit të një qasjeje strategjike, të bazuar në analiza të nevojave dhe në ndërtimin e kapaciteteve të brendshme për zhvillim të qëndrueshëm të sektorit të sigurisë publike.

Të gjeturat sipas kategorizimit të trajnimeve

Kategorizimi i Trajnimeve në Akademi është i bazuar në nivelin e shkathtësive dhe aftësive të konkretizuar me kompetencë të ngritjes profesionale. Bazuar në këtë parim, Akademia ka bërë këtë kategorizim të trajnimeve si në vijim:

- *Trajnimet Profesionale*
- *Trajnimet Themelore*
- *Trajnimet e Avancuara*
- *Trajnimet e Specializuara*
- *Trajnimet për Instruktor/trajner*



Po ashtu në kuadër të trajnimeve të realizuara në Akademi hyjnë edhe trajnimet tjera (**16 trajnime të pa kategorizuara**). Përkundër obligimit që Akademia ka në kategorizimin e të gjitha trajnimeve që mbahen në Akademi, si rrjedhojë e kërkesave urgjente, ato kanë rezultuar në mungesë të kategorizimit të tyre.

Trajnimet Profesionale

Kjo kategori e trajnimeve paraqet procesin e hapave të parë që ndërlidhen me një karrierë apo drejtim specifik të profesionit. Trajnimi profesional fokusohet në aplikimet praktike të aftësive të mësuara dhe në përgjithësi arrin ndërlidhjen e aplikimit të saj në praktikë. Një pjesë e madhe e arsimit në shkollat profesionale është trajnimi praktik. Trajnimi profesional është i bazuar në standardet e profesionit të aprovuara nga Këshilli Drejtues i AKK si parakusht i zhvillimit dhe të cilat si kualifikim janë të sistemuara në kuadër të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve e cila del nga Korniza Evropiane e Kualifikimeve. Akademia bazuar në mandatin e saj ka të aprovuara këto standarde të profesionit nga Këshilli drejtues i AKK-së pas fazës ri shqyrtuese nga KAAPRr i MASHT-it si në vijim:

STANDEDET E APROVUARA NGA AUTORITETI KOMBËTAR I KUALIFIKIMEVE							
Standardet profesionale	Sektori	Zhvilluar	AKK	Riverifikuar	Kodi	Niveli KKK	Valide
Inspektor i Inspektoriatit Policor të Kosovës	Siguri Publike	AKSP	Aprovuar	5/31/2021	3355	5	5/30/2026
Zyrtar Korrektues	Siguri Publike	AKSP	Aprovuar	5/31/2021	5413	5	5/30/2026
Zyrtar Sprovues	Siguri Publike	AKSP	Aprovuar	5/31/2021	2635	5	5/30/2026
Zyrtar Doganor	Siguri Publike	AKSP	Aprovuar	5/31/2021	3351	4	5/30/2026
Zyrtar Policorë	Siguri Publike	AKSP	Aprovuar	5/31/2021	5412	5	5/30/2026
Zjarrfikës	Siguri Publike	AKSP	Aprovuar	6/25/2021	5411	4	6/24/2026

Institucioni i akredituar me trajnimet profesionale të validuara nga këshilli drejtues i AKK-së.

IAAP	KUALIFIKIMI	NIVELI	KREDITË	VENDIMI	AFATET
Akademia e Kosovës për Siguri Publike AKSP	Zyrtar Policor	V	72	7/24/2021	7/23/2024
	Inspektor i inspektoratit Policor të Kosovës	V	83	7/24/2021	7/23/2024
	Zyrtarë Doganor	IV	68	7/24/2021	7/23/2024
	Zyrtarë Korrektues	V	60	7/24/2021	7/23/2024
	Zyrtarë Sprovues	V	34	7/24/2021	7/23/2024
	Zjarrëfikës	IV	80	7/24/2021	7/23/2024

TRAJNIMET PROFESIONALE					
Emri i trajnimit	Numri i trajnimeve të realizuar	Numri i vijuesve	Kohëzgjatja e trajnimit	Mesatarja e përgjithshme e kënaqshmërisë	Nota e përgjithshme mesatare
Trajnimi profesional Zyrtar Korrektues - Gjenerata e 45	1	111	7 muaj	96.5%	4.82
Trajnimi profesional Zyrtar Doganor gr. 01	1	57	6 muaj	89.5%	4.47
Trajnimi profesional Zyrtar Doganor gr. 02	1	51	6 muaj	85.4%	4.27
Trajnimi profesional Zjarrfikës	1	21	6 muaj	Trajnim që përfundon në vitin 2026 duke përfshirë edhe vlerësimin e inernshipit	

Trajnimi profesional “Zyrtar Korrektues”

Trajnimi profesional i validuar në përputhje me planin vjetor të trajnimeve pas hapave rekrutues që zhvillohen nga vetë ISP-ja respektive dhe përgatitjeve që Akademia zhvilloj në koordinim me SHKK, me datë 30.09.2024 filloj gjenerata e 45 e trajnimit profesional “Zyrtar Korrektues” me gjithsejtë 111 kadetë të deklaruar dhe e cila diplomoj me 07.03.2025.

Në kuadër të kësaj gjenerate ishte edhe një kadete nga gjenerata e 44-të, e cila për arsye shëndetësore e ka ndërprerë trajnimin dhe ka vazhduar pjesën e mbetur të trajnimit me gjeneratën e 45 si dhe me datë 04.12.2024 kanë filluar Trajnimin Profesional Zyrtar Korrektues edhe dy kadetë (Fitim Rudari dhe Behar Bajrami) ndërsa trajnimin e kanë përfunduar me datë 08.05.2025.

Trajnimi profesional “Zyrtar Doganor”

Trajnimi profesional i validuar në përputhje me planin vjetor të trajnimeve pas hapave rekrutues që zhvillohen nga vetë ISP-ja respektive dhe përgatitjeve që Akademia zhvilloj në koordinim me DK, me datë 27.01.2025 filloj grupi i parë i trajnimit profesional “Zyrtar Doganor” me gjithsejtë 57 kadetë të deklaruar dhe e cila diplomoj me 11.07.2025. Ndërsa grupi i dytë i trajnimit profesional “Zyrtar Doganor” filloj me datë 03.03.2025 dhe përfundoj me 11.08.2025

Po ashtu vlen të theksohet fakti se me datë 08.09.2025 ka filluar edhe Trajnimi Profesional Zjarrfikës me gjithsejtë 21 kadetë të cilët priten të diplomojnë në vitin 2026 dhe do paraqiten si pjesë e raportit vjetor për vitin 2026.

Akademia zhvilloj planin dinamik të implementimit të trajnimit profesional në përputhje me obligimet që IAAP ka ndaj AKK-së me rastin e fillimit të gjeneratës së re, si caktimi i Koordinatorit të trajnimit nga Akademia dhe ISP-ja respektive si dhe Koordinatorin e Cilësisë nga


Akademia. Po ashtu në kuadër të obligimeve Akademia ofroj listën e deklarimit të grupeve të kandidatëve dhe stafit, si dhe planin e ofrimit të kualifikimit (*shtrirja e orëve sipas ditës, javës si dhe muajit*).

Trajnimi profesional iu nënshtrua këtyre mekanizmave vlerësues gjatë fazës implementuese si në vijim:

- Vlerësimi i modulit nga ana e kadetëve
- Vlerësimi i pjesës praktike të internshipit nga ana e kadetëve


Nga totali i përgjithshëm kemi këto të dhëna të fituara si në vijim:

Trajnimi profesional Zyrtar Korrektues		
Fusha e vlerësuar	Mesatarja e kënaqshmërisë	Nota mesatare
Vlerësimi i moduleve teorike nga ana e kadetëve	96.6%	4.8
Vlerësimi i moduleve praktike të internshipit nga ana e kadetëve	%	



Trajnimi profesional Zyrtar Doganor - 01/2025		
Fusha e vlerësuar	Mesatarja e kënaqshmërisë	Nota mesatare
Vlerësimi i moduleve teorike nga ana e kadetëve	89.0%	4.4
Vlerësimi i moduleve praktike të internshipit nga ana e kadetëve	94.1%	4.7

Trajnimi profesional Zyrtar Doganor - 02/2025		
Fusha e vlerësuar	Mesatarja e kënaqshmërisë	Nota mesatare
Vlerësimi i moduleve teorike nga ana e kadetëve	84.6%	4.2
Vlerësimi i moduleve praktike të internshipit nga ana e kadetëve	94.1%	4.7



Të gjeturat: programi trajnues gjatë fazës implementuese është zhvilluar në përputhje të plotë kohore dhe të shtrirjes së trajnimit profesional meqë numri i kadetëve ka përkuar me numrin e stafit trajnues.

Vlerësimi i moduleve teorike nga ana e kadetëve

- Vlerësimi i mësimnxënies në trajnimin profesional: ka arritur një mesatare të lartë të nivelit të kënaqshmërisë prej 92.05 % ose 4.62 notë mesatare e përgjithshme e regjistruar në modulet trajnuese. Kjo tregon në një nivel të lartë të kënaqshmërisë në fushën e mësimnxënies. Kadetët kanë vlerësuar lartë mësimnxënien e përgjithshme, objektive dhe synimet e qarta të moduleve trajnuese të aspektit teorik të cilat kanë ndikuar në zhvillimin e shkathtësive dhe aftësive profesionale për kualifikimin gjegjës. Kadetët kanë vlerësuar se modulet trajnuese kanë përmbushur pritshmëshmërit e ngritjes së tyre profesionale.

- Materialet mësimore: është arritur një vlerësim i lartë i nivelit të kënaqshmërisë prej 91.31 % ose 4.57 notë mesatare, nisur nga përmbajtja e gjerë tek distribuimi i tyre në kohë. Materiali mësimor i moduleve është shpërndarë në kohë dhe në formatin fizik dhe elektronik. Po ashtu, DSC gjatë vlerësimit të pasqyrave trajnuese ka gjetur se aplikimi i Taksonomisë së Bloomit është në përputhje të plotë me nivelin e KKK të trajnimit në fjalë.
- Prezantimi i trajnerit/instruktorit: nga totali i vlerësimeve në modulet trajnuese teorike, DSC ka pranuar vlerësim të lartë, me 93.20% të nivelit të kënaqshmërisë ose 4.68 notë mesatare për punën, dedikimin dhe përkushtimin që trajnerët/instruktorët kanë treguar në modulet trajnuese. Vlen të ceket se në pothuajse të gjitha modulet trajnuese janë veçuar edhe emrat e përvëqshëm të stafit trajnues/instruktor të cilat janë adresuar në raporte vetanake për secilin modul trajnues, e cila edhe në formatin e përgjithshëm ka treguar se niveli i përgatitjes së trajnerëve/instruktorëve ka qenë i lartë.
- Infrastruktura dhe mjedisi mësimor: ka arritur një mesatare të nivelit të kënaqshmërisë prej 82.57 % ose 4.14 notë mesatare. Kadetët në modulet trajnuese kanë vlerësuar lartë të gjitha mundësitë e ofruara në kuadër të infrastrukturës në kampus, me një nuancë të kërkesave për përmirësim të vazhdueshëm.
- Infrastruktura ndihmëse mësimore: është vlerësuar me vlerësim prej 85.52 % të nivelit të kënaqshmërisë ose 4.29 me notë mesatare. Përkundër një numri të lartë të shfrytëzuesve të infrastrukturës ndihmëse në kampus dhe nivelit të lartë numerik të vlerësuar, mbetet ende pjesa e komenteve ajo që adreson nevojën për përmirësim në disa elemente në kuadër të kampusit si ajo e akomodimit (tek konvikti i meshkujve) e cila kërkon inventarizim urgjent dhe ristrukturim të numrit të banorëve për dhoma.
- Shërbimet në kampus: janë vlerësuar me 85.53 % nivel të lartë të kënaqshmërisë ose 4.31 notë mesatare. Vlerësimin më të lartë në kuadër të shërbimeve shkon për shërbimet me ushqim dhe menzën e kampusit, kurse vlerësimi më i ulët është pjesa e akomodimit, me theks të veçant konvikti i meshkujve i cili nuk plotëson kushtet për qëndrim si pasojë e mungesave të inventarizimit dhe shpërndarjes racionale të banorëve për dhoma duke respektuar edhe rekomandimet e vlerësuesve të jashtëm akreditues.

Vlerësimi i moduleve praktike të internshipit nga ana e kadetëve

- Vlerësimi i internshipit në trajnimin profesional: ka arritur një mesatare të lartë të nivelit të kënaqshmërisë prej 95.74 % ose 4.80 notë mesatare e përgjithshme e regjistruar në modulet trajnuese praktike (internshipin). Kjo tregon në një nivel të lartë të kënaqshmërisë në fushën e praktikimit praktik të mësimnxënijes. Përvoja e fituar nga kadetët dhe njohja nga afër e detyrave dhe përgjegjësi të zyrtarëve të ardhshëm me punën, profesionin dhe institucionin punëdhënës ka qenë e shprehur edhe në kuadër të komenteve nga ana e kadetëve si njëra nga përvojat më të mira në kuadër të trajnimit profesional.
- Aktivitetet e AKSP-së në organizimin e Internshipit: ka arritur një mesatare të lartë të nivelit të

kënaqshmërisë prej 91.54 % ose 4.58 notë mesatare e përgjithshme e regjistruar në modulet trajnuese praktike (internshipin) pjesa e aktiviteteve të akademisë në organizimin e përgjithshëm të internshipit. Kadetët kanë vlerësuar shumë lartë angazhimin e akademisë në kuadër të organizimit të internshipit, vizitat e bëra në terren nga përfaqësuesit e Akademisë dhe mbi të gjitha takimet paraprake përgaditore rreth moduleve të internshipit.

- Aktiviteti i institucionit përkatës në aranzhimin e Internshipit: ka arritur një mesatare të lartë të nivelit të kënaqshmërisë prej 95.87 % ose 4.79 notë mesatare e përgjithshme e regjistruar në modulet trajnuese praktike (internshipin) pjesa e aktiviteteve të ndërmarra nga institucioni nikoqir në aranzhimin e internshipit. Rol të veçantë i kanë kushtuar mentorëve dhe stafit në kuadër të institucioneve në të cilat është implementuar moduli i praktikës profesionale e sidomos ndihmesën që i'u është ofruar.
- Vlerësimi i arritjes së rezultateve të internshipit: ka arritur një mesatare të lartë të nivelit të kënaqshmërisë prej 95.44 % ose 4.92 notë mesatare e përgjithshme e regjistruar në modulet trajnuese praktike (internshipin) në arritjen e përgjithshme të rezultateve të pritura të cilat kanë pas një itinerar gjerë në detajet ditore të hartuara nga Koordinatori i Internshipit në bashkëpunim me mentorët në terren.
- Vlerësimi i mentorëve të internshipit: ka arritur një mesatare të lartë të nivelit të kënaqshmërisë prej 98.46 % ose 4.92 notë mesatare e përgjithshme e regjistruar në modulet trajnuese praktike (internshipin) në kuadër të vlerësimeve të mentorëve të cilat në komente janë të shkëlqyera dhe që përkohë edhe me raportet e internshipit nga terreni. Mentorët kanë arritur të ndërlidhin pjesën teorike dhe praktike tek kadetët dhe kanë tjekaluar të priturat duke ofruar këshilla edhe jashtë orarit të punës.

Rekomandim: plani i ANT-së për trajnimin profesional të jetë i koordinuar me Akademinë dhe në rivalidimin e radhës së trajnimit profesional të rishikohet programi pjesët e identifikuar si nevojë për ndryshim. Po ashtu rekomandojmë që të digjitalizohet sistemi i të dhënave dhe listave në SHKK duke i ofruar Akademisë informatë më të shpejtë rreth kadetëve dhe përmbushjes së obligimeve ndaj AKK si deklarimi i stafit dhe i pjesëmarrësve në trajnim. Në aspektin e moduleve praktike të internshipit kërkojmë përmirësim të vazhdueshëm dhe njëherësh njohje për punën e palodhshme të mentorëve në institucionet përkatëse nëpër të cilat është realizuar pjesa praktike.

Trajnimet Themelore

Kjo kategori e trajnimit paraqet procesin e marrjes së njohurive themelore në aspektin teorik dhe praktik për zyrtarët përkatës të agjencive të sigurisë publike, të cilat ballafaqohen me detyrat dhe përgjegjësitë përkatëse gjatë ushtrimit të profesionit të tyre për profilin profesional në sektorët e ndryshëm të ISP-ve respektive.

TRAJNIMET THEMELORE					
Emri i trajnimit	Numri i trajnimeve të realizuar	Numri i vijuesve	Kohëzgjatja e trajnimit	Mesatarja e kënaqshmërisë	Nota mesatare
Trajnimi Themelor “Zyrtar Policor” gjenerata#61 (462 gjithsej kurse 354 kane marre pjese ne vlerësim)	1	354	62	87.9%	4.39
Trajnimi Themelor “Zyrtar Policor” gjenerata#62 (279 gjithsej kurse 265 kane marre pjese ne vlerësim)	1	265	65	87.7%	4.38
Aksidentet e Komunikacionit Rrugor	1	12	5	91.7%	4.58
Bazat e Menaxhimit Emergjent	1	21	5	78.4%	3.92
Trajnimin Bazik Zjarrfikje dhe Shpëtim	1	50	10	91.9%	4.60
Të Drejtat e Njeriut	1	15	1	86.4%	4.32
Elementet Bazë të Menaxhimit	1	21	5	91.3%	4.57
Trajnimin Themelor Hetimi i Krimit	1	22	19	65.3%	3.27
Trajnimin Themelor Hetimi i Krimit	1	25	19	72.0%	3.60
Llaser dhe Alko-test	1	20	2	75.4%	3.77
Materiet e Rrezikshme	1	9	4	90.1%	4.50
Menaxhimi i Vijës së Parë – AKSP	1	18	29	91.0%	4.55
Menaxhimi i Zemërimit	1	15	5	96.3%	4.81
Përdorimi i Mjeteve Themelore për Shuarjen e Zjarrit	1	11	2	99.2%	4.96
Qendrat e Ndalimit	1	22	5	84.0%	4.20
Sjellja me Njerëz dhe Detyrat në Vendin e Punës	1	10	5	88.2%	4.41
Trajnimi Bazik i Forumeve të Sigurisë për Reagim Emergjent	1	13	5	96.7%	4.84
Intervista Motivuese	1	17	3	93.4%	4.67
Trajnimin me Motoçikletë Skuter	1	11	21	91.5%	4.57
Vlerësimi i Rrezikut dhe Nevojave për Recidivizëm	1	7	5	97.2%	4.86
Vlerësimi i Rreziqeve	1	11	3	90.1%	4.51
Zvogëlimi i Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera	1	13	2	94.1%	4.70
Trajnimin me Motoçikletë Skuter	1	4	21	91.5%	4.57
Hetimi i Trafikimit të Drogës	1	20	4	95.0%	4.57
Qendrat e Ndalimit	1	18	5	80.1%	4.01
Trajnimi për Zyrtarë të Sigurimit	1	24	5	96.97%	4.85
Trajnimi për Zyrtarë të Sigurimit	1	24	5	94.1%	4.71
Trajnimi për Zyrtarë të Sigurimit	1	26	5	95.7%	4.78
Trajnimi për Zyrtarë të Sigurimit	1	13	5	95.1%	4.76
Trajnimi themelor për pisolletën Glock 9x19	1	16	5	93.0%	4.65
Qendrat e Ndalimit	1	13	5	89.3%	4.47


Trajnimi Bazik i Policisë Kufitare FRONTEX	1	18	20	85.1%	4.26
Vlerësimi i Rrezikut dhe Nevojave për Recidivizëm	1	15	5	89.0%	4.45
Ndërgjegjësimi, parandalimi dhe luftimi i korrupsionit	1	21	5	89.6%	4.48
Trajnimi Bazik i Forumeve të Sigurisë për Reagim Emergjent	1	12	5	95.1%	4.76
Menaxhimi i aksidenteve radiologjike dhe berthamore si dhe zbulimi i kontrabandës së tyre	1	7	3	86.2%	4.31

Nga totali i 36 trajnimeve themelore:

- 35 trajnime janë realizuar në kampusin e Akademisë, kurse
- 1 trajnim jashtë kampusit të Akademisë, (por që i është nënshtruar procesit të testimit dhe vlerësimit nga Akademia, përfshirë edhe certifikimin e vijuesve).

Zbërthimi i trajnimeve themelore si në vijim:

- 36 trajnime themelore në përgjithësi,
- 1193 vijues në total,
- 88.3% mesatarja e kënaqshmërisë, ose
- 4.4 nota mesatare.



Nga totali i 36 trajnimeve themelore të realizuara me gjithsejt 1193 pjesëmarrës, DSC ka pas qasje vetëm në vlerësimin e të gjitha trajnimeve themelore.

Të gjeturat programet trajnuese të fushës së trajnimeve themelore-themelore janë zhvilluar në përputhje me kërkesat e ISP-ve respektive.

- Vlerësimi i mësimnxënijes: ka arritur një mesatare të lartë të nivelit të kënaqshmërisë prej 88.05 % ose 4.43 notë mesatare e përgjithshme e regjistruar në trajnimet themelore. Kjo tregon në një nivel të lartë të kënaqshmërisë në fushën e mësimnxënijes. Pjesëmarrësit kanë vlerësuar lartë mësimnxënijen e përgjithshme, objektive dhe synimet e qarta të trajnimit të cilat kanë ndikuar në zhvillimin e shkathtësive dhe aftësive themelore të kërkuara për fushat përkatëse. Pjesëmarrësit kanë vlerësuar se trajnimet themelore kanë përmbushur pritshmësit e ngritjes së tyre profesionale.
- Materialet mësimore: është arritur një vlerësim i lartë i nivelit të kënaqshmërisë prej 88.59% ose 4.44

notë mesatare, nisur nga përmbajtja e gjerë tek distribuimi i tyre në kohë. Në kuadër të disa komenteve janë dhënë sinjale për krijimin e sistematizimit periodik të rishikimit të materialit e cila mungon në Akademi. Po ashtu, DSC gjatë vlerësimit të pasqyrave trajnuese ka gjetur se mungon aplikimi i Taksonomisë së Bloomit e cila përcakton nivelin e trajnimit në përputhje me kategorizimin e trajnimeve.

- Prezantimi i trajnerit/instruktorit: nga totali i vlerësimeve në trajnimet themelore, DSC ka pranuar vlerësimin më të lartë në kuadër të fusha vlerësuese, me 91.30% të nivelit të kënaqshmërisë ose 4.58 notë mesatare për punën, dedikimin dhe përkushtimin që trajnerët/instruktorët kanë treguar në trajnimet themelore. Vlen të ceket se në shumicën e trajnimeve themelore janë veçuar edhe emrat e përvëqshëm të stafit trajnues/instruktor të cilat janë adresuar në raporte vetanake për secilin trajnim, e cila edhe në formatin e përgjithshëm ka treguar se niveli i përgatitjes së trajnerëve/instruktorëve ka qenë i lartë.
- Infrastruktura dhe mjedisi mësimor: ka arritur vlerësim të lartë të kënaqshmërisë prej 81.16% ose 4.09 notë mesatare. Pjesëmarrësit në trajnime themelore përkundër vlerësimit të lartë numerik të deklaruar, në kuadër të komenteve kanë potencuar nevojën për përmirësim të vazhdueshëm, sidomos në mungesa tek pajisjet e ndryshme ndihmëse për zhvillimin e trajnimit, nivelit të pastërtisë dhe mirëmbajtjes.
- Infrastruktura ndihmëse mësimore: është vlerësuar me vlerësim prej 89.09 % të nivelit të kënaqshmërisë ose 4.47 me notë mesatare. Përkundër një numri të lartë të shfrytëzuesve të infrastrukturës ndihmëse në kampus dhe nivelit të lartë numerik të vlerësuar, mbetet ende pjesa e komenteve ajo që adreson nevojën për përmirësim në disa elemente në kuadër të kampusit si nevoja për mirëmbajtje. Pjesa infrastrukturore ndihmëse për zhvillimin e pjesës praktike bazuar në vlerësimin e DSC sipas proceseve akredituese, është vlerësuar se kanë kaluar afatin e amortizimit; sikurse ato të sallës së edukatës fizike, poligonit të vozitjes, shenjave sinjalizuese, laboratorit, mosfunksionimi i qytetëzës simulative, dhoma e webinarëve si dhe mungesa të adresuara në kuadër të materialeve shpenzuese ditore.
- Shërbimet në kampus: janë vlerësuar me 89.34% nivel të lartë të kënaqshmërisë ose 4.48 notë mesatare. Vlerësimin më të lartë në kuadër të shërbimeve shkon për shërbimet me ushqim dhe menzën e kampusit, kurse vlerësimi më i ulët është pjesa e akomodimit, me theks të veçant konvikti i meshkujve i cili nuk plotëson kushtet për qëndrim si pasojë e mungesave të inventarizimit dhe shpërndarjes racionale të banorëve për dhoma duke respektuar edhe rekomandimet e vlerësuesve të jashtëm akreditues.

Të gjeturat e përgjithshme, vlen të ceket se si pasojë e mos planifikimit racional të ISP-ve në kërkesat e tyre për trajnim, ka rezultuar edhe mospërfillja dhe shkurtim i trajnimeve të planifikuara gjerë në implementim të disa trajnimeve jashtë kampusit të Akademisë. Trajnimet e zhvilluara në kuadër të kampusit kanë arrit një mesatare të kënaqshme vlerësuese me disa rekomandime për

përmirësim sidomos në fushën e implementimit të taksonomisë së Bloom-it e cila kërkon rishikim të trajnimeve.

Nga ana tjetër, trajnimet që ofrojnë një profesion/kualifikim të caktuar, janë të bazuara në Standardet e Profesionit, sipas të cilave Akademia ka të aprovuara standardet me funksionet e tyre të shtjelluara në trajnimet profesionale të validuara në AKK, duke siguruar një kompetencë të plotë të zyrtarëve të rinj, dhe kjo asesi nuk mund të ofrohen në kuadër të trajnimeve themelore. Ato ofrohen përmes trajnimeve të validuara dhe të ofruara nga një Institucion i akredituar për Aftësimin dhe Arsimin Profesional IAAP siq është Akademia, me kurrikulë të validuar në kuadër të së cilës fitohet aftësi dhe shkathtësi të cilat përmbillen me kompetencë veprimi në përputhje me kohëzgjatjen e kualifikimit dhe kredive të trajnimit profesional, të aprovuar nga KD i AKK-së.

Rekomandim: plani i ANT-së për trajnime të jetë i koordinuar me Akademinë dhe racionalizimi i implementimit të trajnimeve të jetë konform mundësive që Akademia ofron në përputhje me nevojat e të gjitha ISP-ve respektive. Rekomandojmë që fazat e implementimit të trajnimeve profesionale sidomos të atyre që ofrojnë kompetencë profesionale, të jenë në përputhje me trajnimet e validuara përkrah obligimeve që i ka një institucion i akredituar për aftësim dhe arsim profesional. Po ashtu, të krijohet një politikë për procesin e rishikimit të trajnimeve bazuar në taksonominë e Bloomit sipas foljeve vepruese në kuadër të nivelit të kualifikimeve me çka definon qartë se cilat folje duhet përdorur për llojin e trajnimeve themelore. Andaj është mase e nevojshme dhe urgjente të krijohet politikë sistematike e rishikimit të materialeve trajnuese ose të rishikohet Udhëzim Administrativ nr. 01/2012 - AKSP për trajnime dhe zhvillimin e kurrikulave. Ajo çka DSC ka regjistruar është se ekziston nevoja për ta trajtuar me prioritet përmirësimin e infrastrukturës ndihmëse mësimore (sipas vlerësimit të eksperëve të jashtëm). Po ashtu mungojnë të dhënat në web-faqe të Akademisë rreth trajnimeve të cilat përkundër një angazhimi të jashtëzakonshëm që ndodh në kampus, nuk pasqyrohet as edhe një informatë e vetme për to.

Trajnimet e Avancuara

Kjo kategori e trajnimit ndryshe nga ato themelore, Trajnimet e avancuara paraqesin procesin e përvetësimit të njohurive në shkallë të avancuar në aspektin teorik dhe praktik për zyrtarët përkatës të agjencive të sigurisë publike që në fushën e tyre do të jenë në gjendje të punojnë pa mbikëqyrje ose mbikëqyrje të kufizuar.


TRAJNIMET E AVANCUARA					
Emri i trajnimit	Numri i trajnimeve të realizuar	Numri i vijuesve	Kohëzgjatja e trajnimit	Mesatarja e kënaqshmërisë	Nota mesatare
Përdorimi i Armës MP-5	3	26	5	97.1%	4.8
Luftimi i Basteve dhe Lojërave të Fatit të Paligjshme"	1	18	5	77.3%	3.87
Mbrojtja e Afërt	1	15	21	98.4%	4.92
Ndryshimet e Pësura me Kodin e Ri Doganor"	1	21	3	75.4%	3.77
Trajnim për Planifikim Operativ	1	17	5	86.3%	4.31
Krimteknikët e Vendit të Ngjarjes"	2	43	30	66.15%	3.3
Menaxhimi i Trafikut dhe Hetimi i Aksidenteve"	1	24	19	85.6%	4.28
Trajnimi i Avancuar Hetimi i Krimeve	2	42	15	56.65%	2.83
Hetimi i Dhunës në Familje	1	20	5	70.5%	3.52
Delikuenca e të miturve	1	19		73.1%	3.66
Ngasja Emergjente	34	432	5	91.08%	4.55

Zbërthimi i trajnimeve të avancuara si në vijim:

- 48 trajnime të avancuara,
- 677 vijues në total,
- 85.9% mesatarja e kënaqshmërisë, ose
- 4.29 nota mesatare.

45 trajnime janë realizuar në kampusin e Akademisë, kurse

- 3 trajnime jashtë kampusit të Akademisë, (por që i është nënshtruar procesit të testimit dhe vlerësimit nga Akademia, përfshirë edhe certifikimin e vijuesve).



Nga totali i 48 trajnimeve të realizuara me gjithsejt 677 pjesëmarrës, DSC ka pas qasje në vlerësimin e të gjitha trajnimeve të avancuara.

Të gjeturat programet trajnuese të fushës së trajnimeve të avancuara janë zhvilluar në përputhje me kërkesat e ISP-ve respektive.

- **Vlerësimi i mësimnxënijes:** ka arritur një vlerësim të lartë të nivelit të kënaqshmërisë prej 84.65 % ose 4.25 notë mesatare e përgjithshme e regjistruar në trajnimet e avancuara. Kjo tregon në një nivel të lartë të kënaqshmërisë në fushën e mësimnxënijes. Pjesëmarrësit kanë vlerësuar lartë mësimnxënijen e përgjithshme, objektive dhe synimet e qarta të trajnimit të cilat kanë ndikuar në zhvillimin e shkathtësive dhe aftësive themelore të kërkuara për fushat përkatëse. Pjesëmarrësit kanë vlerësuar se trajnimet e avancuara janë pikërisht rrugëtimi i tyre i kërkuar edhe avancimin e kompetencës profesionale të fushës.
- **Materialet mësimore:** është arritur një vlerësim i lartë i nivelit të kënaqshmërisë prej 83.68% ose 4.21 notë mesatare, nisur nga përmbajtja e gjerë tek distribuimi i tyre në kohë. Në kuadër të disa komenteve janë prekur edhe nevoja për rishikimit të materialit. Po ashtu, DSC gjatë vlerësimit të pasqyrave trajnuese ka gjetur se mungon aplikimi i drejtë i Taksonomisë së Bloomit e cila përcakton nivelin e trajnimit në përputhje me kategorizimin e trajnimeve.
- **Prezantimi i trajnerit/instruktorit:** DSC ka pranuar vlerësimin të lartë me 88.69% të nivelit të kënaqshmërisë ose 4.46 notë mesatare për punën, dedikimin dhe përkushtimin që trajnerët/instruktorët kanë treguar në trajnimet e avancuara. Vlen të ceket se janë veçuar edhe emrat e përveqshëm të stafit trajnues/instruktor të cilat janë adresuar në raporte vetanake për secilin trajnim, e cila edhe në formatin e përgjithshëm ka treguar se niveli i përgatitjes së trajnerëve/instruktorëve ka qenë i lartë.
- **Infrastruktura dhe mjedisi mësimor:** ka arritur një mesatare të nivelit të kënaqshmërisë prej 82.12 % ose 4.13 notë mesatare. Pjesëmarrësit në trajnime të avancuara kanë potencuar nevojën për përmirësim të vazhdueshëm të infrastrukturës e posaqërisht poligonit të vozitjes dhe pajisjeve përcjellëse. Akademia edhe pse ka vendosur prioritet rregullimin e pajisjes Skid-Car (mekanizimit rrëshqitës në trajnimet e trafikut) gjerë në momentin e përmbledhës së raportit, pajisja mbetet ende jofunksionale.
- **Infrastruktura ndihmëse mësimore:** është vlerësuar me vlerësim prej 86.16 % të nivelit të kënaqshmërisë ose 4.33 me notë mesatare. Përkundër një numri të lartë të shfrytëzuesve të infrastrukturës ndihmëse në kampus dhe nivelit të lartë numerik të vlerësuar, mbetet ende pjesa e komenteve ajo që adreson nevojën për përmirësim në disa elemente në kuadër të kampusit si nevoja për mirëmbajtje. Pjesa infrastrukturore ndihmëse për zhvillimin e pjesës praktike bazuar në vlerësimin e DSC sipas proceseve akredituese, është vlerësuar se kanë nevojë për përmirësim sikurse ato të poligonit të vozitjes.
- **Shërbimet në kampus:** janë vlerësuar me 87.49 % nivel të lartë të kënaqshmërisë ose 4.38 notë mesatare. Vlerësimin më të lartë në kuadër të shërbimeve shkon për shërbimet me ushqim dhe menzën e kampusit, një pjesë i adresohet transportit dhe shërbimeve tjera përcjellëse gjer tek ajo e përkthimit.

Të gjeturat e përgjithshme, vlen të ceket që pothuajse kemi të njëjtën rezultat të të gjeturave në trajnimet e avancuara sikurse tek ato themelore. Trajnimet e zhvilluara në kuadër të kampusit kanë arrit një mesatare të kënaqshme vlerësuese me disa rekomandime për përmirësim sidomos në fushën e implementimit të taksonomisë së Bloom-it e cila kërkon rishikim të trajnimeve. Mbetet prioritet funksionalizimi i pajiseve përcjellëse për trajnimet e trafikut dhe elementeve përcjellëse gjerë tek shenjat që përdoren në poligon të vozitjes.

Akademia gëzon staf të trajnimeve të fushës përmes ISP-ve duke përfshirë edhe stafin akademik në kanalizimin e duhur të trajnimeve në aspektin përmbajtësor, duke mos anashkaluar edhe listën e ekspertëve që akademja posedon dhe lidh kontrat me ta në baza vjetore për nevoja të trajnimeve, e cila do duhej të ishte një kombinim me produkt cilësor të rishikuar.

Rekomandim: plani i ANT-së për trajnime të avancuara të jetë i koordinuar me Akademinë përfshirë identifikimin e atyre trajnimeve të cilat janë mandatorë për avancimin profesional të zyrtarëve të ISP-së sipas planit paraprak dhe nevojave të identifikuara nga vitit paraprak. Trajnimet e planifikuara të mbahen në kampusin e Akademisë, dhe po ashtu kërkohet që Akademia të rrisë nivelin e pjesëve ndihmëse infrastrukture për zhvillimin e trajnimeve në aspektin praktik. Po ashtu rekomandojmë që të bëhet rishikimi i trajnimeve bazuar në taksonominë e Bloomit e cila duhet harmonizuar edhe me materialet prezantuese të instruktorëve/ligjëruesve në trajnim.


Trajnimet për Instruktor

Kjo kategori e trajnimit, paraqet një fushë të përgatitjes së kuadrove të reja të instruktorëve /ligjëruesve në fushën e trajnimeve në aspektin teorik dhe praktik për zyrtarët përkatës të agjencive të sigurisë publike, të cilët do të marrin kompetencën për mësimdhënie në cilësinë e instruktorit.

TRAJNIMET PËR INSTRUKTOR					
Emri i trajnimit	Numri i trajnimeve të realizuar	Numri i vijuesve	Kohëzgjatja e trajnimit	Mesatarja e kënaqshmërisë	Nota mesatare
Programi për Aftësimin e Instruktorëve	1	20	19	76.7%	3.83
Trajnimi për Trajner të Armëve të Zjarrit	1	23	17	96.4%	4.82
Instruktor i Taktikave Mbrojtëse dhe ushtrimeve fizike	1	27	50	82.8%	4.14
Trajner i Trajnerëve për Armë të Zjarrit	1	21		86.8%	4.34

Zbërthimi i trajnimeve për instruktor si në vijim:

- 4 trajnime për instruktorë,
- 91 vijues në total,
- 85.6% mesatarja e kënaqshmërisë, ose
- 4.28 nota mesatare.



Nga totali i 4 trajnimeve të realizuara me gjithsejt 91 pjesëmarrës, DSC ka vlerësuar 4 trajnimet e planifikuara brenda vitit 2025.

Të gjeturat programet trajnuese të fushës së trajnimeve për instruktorë janë zhvilluar në përputhje me kërkesat e ISP-ve respektive.

- **Vlerësimi i mësimnxënies:** ka arritur një mesatare të lartë të nivelit të kënaqshmërisë prej 86.34 % ose 4.34 notë mesatare e përgjithshme. Kjo tregon në një nivel të lartë të kënaqshmërisë në fushën e mësimnxënies. Pjesëmarrësit kanë vlerësuar lartë mësimnxënijen e përgjithshme, objektivat dhe synimet e qarta të trajnimit të cilat kanë ndikuar në zhvillimin e shkathtësive dhe aftësive themelore të kërkuara për fushat përkatëse e krijimit të kuadrove të reja trajnuese.
- **Materialet mësimore:** është arritur një vlerësim i lartë i nivelit të kënaqshmërisë prej 84.23 % ose 4.22

notë mesatare, nisur nga përmbajtja e gjerë tek distribuimi i tyre në kohë. DSC gjatë vlerësimit të pasqyrave trajnuese ka gjetur se mungon aplikimi i drejtë i Taksonomisë së Bloomit e cila përcakton nivelin e trajnimit në përputhje me kategorizimin e trajnimeve.

- Prezantimi i trajnerit/instruktorit: nga totali i vlerësimeve, DSC ka pranuar vlerësimin më të lartë në kuadër të fusha vlerësuese, me 91.03 % të nivelit të kënaqshmërisë ose 4.59 notë mesatare për punën, dedikimin dhe përkushtimin që trajnerët/instruktorët kanë treguar në trajnimet për instruktorë duke nxjerr kuadro të reja në nivel. Vlen të ceket se janë veçuar edhe emrat e përveqshëm të stafit trajnues/instruktor të cilat janë adresuar në raporte vetanake për trajnimin në fjalë, dhe e cila e dëshmon faktin se Akademia në kuadër të rrjetit të trajnerëve për trajner/instruktorë ka treguar se niveli i përgatitjes së trajnerëve/instruktorëve ka qenë i lartë dhe është një aset për tu njohur.
- Infrastruktura dhe mjedisi mësimor: ka arritur një vlerësim të lartë të kënaqshmërisë prej 80.92 % ose 4.10 notë mesatare. Infrastruktura dhe mjedisi mësimor është vlerësuar lartë nga ana e pjesëmarrësve mbështetur edhe me komentet e ofruara. Pjesëmarrësit kanë vlerësuar lartë mundësitë infrastrukturore që ofrohen në kampus si të mjaftueshme për zhvillimin e mësimit teorik dhe atij praktikë, me një nivel të lartë të ambienteve mësimore të cilat janë në nivel të mirëmbajtura. Pjesëmarrësit kanë vlerësuar edhe hapësirat përcjellesë për rekreacion, vlerësim ky i mbështetur edhe nga ana e komenteve të ofruara.
- Infrastruktura ndihmëse mësimore: është vlerësuar me vlerësim prej 87.36 % të nivelit të kënaqshmërisë ose 4.37 me notë mesatare. Përkundër vlerësimit të lartë, mbetet ende nevoja për përmirësim të vazhdueshëm prioritet i Akademisë, sidomos tek pjesa e mirëmbajtjes, materialeve elementare dhe shërbimeve logjistike.
- Shërbimet në kampus: janë vlerësuar me 86.85 % nivel të lartë të kënaqshmërisë ose 4.34 notë mesatare. Vlerësimin më të lartë në kuadër të shërbimeve shkon për shërbimet me ushqim dhe menzën e kampusit, por vazhdimisht rekomandohet të rishikohet mundësia e përmirësimit të kushteve për pjesëmarrës duke e vendosur pjesëmarrësin/vijuesin në qendër.

Rekomandim: trajnimet për instruktor në kuadër të programit kanë edhe pjesën e ricertifikimi të instruktorëve të cilat jo gjithnjë zbatohen në afatet e përcaktuara nga programi për instruktor. Rekomandojmë rritjen e numrit të trajnimeve për trajner si nevojë e ISP-ve respektive nga fushat e identifikuara sipas ANT-së. Po ashtu rekomandojmë që të bëhet rishikimi i trajnimeve bazuar në taksonominë e Bloomit e cila duhet harmonizuar edhe me materialet prezantuese të instruktorëve/ligjëruesve në trajnim. Njëherësh rekomandojmë që Akademia të përgatis hapësirat mësimore në përputhje me specifikat e trajnimeve dhe kjo ndarje të bëhet për të gjitha kategoritë.


Trajnime tjera

Në kuadër të trajnimeve tjera hyjnë trajnimet e pa kategorizuara që realizohen në Akademi. Përkundër obligimit që Akademia ka në kategorizimin e të gjitha trajnimeve që mbahen në Akademi, si rrjedhojë e kërkesave urgjente dhe në një masë neglizhuese ndaj akademisë, ato kanë rezultuar në mungesë të kategorizimit të tyre. Shumica e trajnimeve janë trajnime me partnerë ndërkombëtar por kemi edhe nga to me ISP-të respektive si dhe trajnime të realizuara nga vetë Akademia. Kjo njëherësh ka qenë edhe arsyeja e mungesës së raporteve vlerësuese meqë si njësi vlerësuese nuk na është ofruar qasje në vlerësim.

TRAJNIMET TJERA (TË PA KATEGORIZUARA)					
Emri i trajnimit	Numri i trajnimeve të realizuar	Numri i vijuesve	Kohëzgjatja e trajnimit	Mesatarja e kënaqshmërisë	Nota mesatare
Trajnimi Hetimi i Trafikimit të Drogës	1	20	4	95.0%	4.75
Trajnimi Burimet e Fshehta Njerëzore të Inteligjencës	1	12	10	86.0%	4.30
Microsoft Excel për Operacione	1	10	4	DSC nuk pas qasje në vlerësim	
Trajnimi Analiza e Inteligjencës dhe Teknikat Analitike të Strukturuara	1	11	5	DSC nuk pas qasje në vlerësim	
Trajnimi për Dronë	1	6	2	DSC nuk pas qasje në vlerësim	
Trajnimi Luftimi i Basteve dhe Lojërave të Fatit të Paligjshme Online	1	18	5	77.3%	3.87
Trajnimi për Hetimet e Brendshme për Policinë e Kosovës	1	19	5	86.0%	4.30
Ndryshimet e Pësura me Kodin e Ri Doganor"	1	21	3	75.4%	3.77
Trajnimi të Drejtat e Njeriut	1	15	1	86.4%	4.32
Trajnimi Barazia Gjinore	1	22	1	DSC nuk pas qasje në vlerësim	
Trajnimi Luftimi i Krimit Mjedisor	1	20	2	DSC nuk pas qasje në vlerësim	
Trajnimi i Trajnerëve mbi De-eskalimin dhe Komunikimin e Ndjeshëm Gjinor	1	30	2	DSC nuk pas qasje në vlerësim	
Kursi i Certifikimit të Programit të Sigurisë së OSBE	1	13	5	DSC nuk pas qasje në vlerësim	
Trajnimi Mbrojtja e të Dhënave Personale	1	21	1	DSC nuk pas qasje në vlerësim	
Trajnimi Ngacmimet Seksuale në Vendet e Punës	1	23	1	DSC nuk pas qasje në vlerësim	
Trajnimi Etika në Vendin e Punës	1	30	1	DSC nuk pas qasje në vlerësim	

Zbërthimi i trajnimeve tjera (të pa kategorizuara) si në vijim:

- 16 trajnime tjera të pa kategorizuara,
- 291 vijues në total,
- 84.35 % mesatarja e kënaqshmërisë, ose
- 4.21 nota mesatare.



Nga totali i 16 trajnimeve të realizuara me gjithsejt 291 pjesëmarrës, DSC ka pas qasje në vlerësimin e 6 trajnimeve tjera. Në kuadër të trajnimeve të pa vlerësuar janë 10 trajnimet në të cilat nuk kemi pas qasje dhe në të cilat nuk është aplikuar faza testuese.

Të gjeturat programet trajnuese të fushës së trajnimeve tjera (të pa kategorizuara) janë zhvilluar në përputhje me kërkesat e PN dhe ISP-ve respektive.

- **Vlerësimi i mësimnxënies:** ka arritur një mesatare të lartë të nivelit të kënaqshmërisë prej 88.54 % ose 4.42 notë mesatare e përgjithshme. Kjo tregon në një nivel të lartë të kënaqshmërisë në fushën e mësimnxënies. Pjesëmarrësit kanë vlerësuar lartë mësimnxënijen e përgjithshme, objektivave dhe synimet e qarta të trajnimit të cilat kanë ndikuar në zhvillimin e shkathtësive dhe aftësive themelore të kërkuara për fushat përkatëse e krijimit të kuadrove të reja trajnuese.
- **Materialet mësimore:** është arritur një vlerësim i lartë i nivelit të kënaqshmërisë prej 82.67 % ose 4.13 notë mesatare, nisur nga përmbajtja e gjerë tek distribuimi i tyre në kohë. DSC nuk pas qasje në pasqyrat trajnuese meqë si trajnime nuk i janë nënshtruar procesit të standardizimit të trajnimeve në Akademi andaj edhe janë të pa kategorizuara si të tilla. Materaili nuk është dorëzuar në kohë kurse nevoja për zhvillim ka qenë prioritet i kohës.
- **Prezantimi i trajnerit/instruktorit:** nga totali i vlerësimeve, DSC ka pranuar vlerësimin më të lartë në kuadër të fusha vlerësuese, me 91.20 % të nivelit të kënaqshmërisë ose 4.56 notë mesatare për punën, dedikimin dhe përkushtimin që trajnerët/instruktorët kanë treguar në trajnimet e specializuara.
- **Infrastruktura dhe mjedisi mësimor:** ka arritur një mesatare të lartë të kënaqshmërisë prej 84.0 % ose 4.2 notë mesatare. Pjesëmarrësit kanë dalë të kënaqur me infrastukturë edhe pse në kuadër të komenteve dhe monitorimit nga DSC nevoja për funksionalizimin e dhomës së Webinarit është mase jetike në trajnimet e natyrës online të cilat kanë rezultuar me anulimin e vlerësimit të një trajnimi si pasojë e pengesave teknike të kohës.
- **Infrastruktura ndihmëse mësimore:** është vlerësuar me vlerësim prej 90.70 % të nivelit të kënaqshmërisë ose 4.53 me notë mesatare. Pjesëmarrësit kanë vlerësuar lartë infrastukturën ndihmëse në kampus dhe kanë kërkuar që të vazhdohet në përmirësimin e vazhdueshëm të saj.
- **Shërbimet në kampus:** janë vlerësuar me 85.27 % nivel të lartë të kënaqshmërisë ose 4.26 notë mesatare. Vlerësimin më të lartë në kuadër të shërbimeve shkon për shërbimet me ushqim dhe menzën e kampusit, kurse vlerësimin më të ulët e kemi për shërbimet me IT, logjistikë dhe mirëmbajtjen e

kampusit.

Rekomandim: trajnimet tjera (të pa kategorizuara) përkundër realizimit të tyre do duhej të nënshtroheshin procesit të standardizimit të trajnimeve në Akademi duke respektuar afatet kohore në dorëzimin e materialit dhe kodimit të tyre sipas kategorisë së trajnimeve në Akademi. Rekomandojmë që në të ardhmen trajnimet e kësaj natyre të jenë në numër më të vogël ose të evitohen tërësisht meqë Akademi posedon një ANT e cila bëhet çdo vit, dhe nevojat urgjente mendoj se do duhej të akomodoreshin në përputhje me obligimet që dalin karshi UA për zhvillimin e kurrikulave dhe testimeve.

[Të gjeturat sipas trajnimeve për ISP](#)

Në vazhdim kemi paraqitur trajnimet të cilat janë realizuar në Akademi për ISP-të Janar - Dhjetor 2025. Përkundër 62 trajnimeve të planifikuara për vitin 2025 janë realizuar 82 trajnime për vitin 2025 objekt i vlerësimit kanë qenë trajnimet të cilat janë të tipit trajnim me test e që nënkupton certifikimin apo matjet e arritshmërisë së kompetencës e të cilat janë objekt i yni vlerësues. Procesi i certifikimit të pjesëmarrës në kuadër të trajnimeve kalon përmes testimit me standardin minimal 70% të përgjigjeve të sakta. Trajnimet e tipit ricertifikues dhe të atyre të mbyllura përkundër realizimit në Akademi, nuk vlerësohen nga DSC, bazuar në kërkesat e njësive në përputhje me politikat trajnuese në Akademi.

Plani i trajnimeve për ISP	Planifikuara		Realizuara	
	trajnime	vijues	trajnime	vijues
Policia e Kosovës	22	1279	66	1698
Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave	17	412	9	149
Shërbimi Korrektues i Kosovës	16	300	7	165
Inspektorati Policor i Kosovës	4	60	/	/
Shërbimi Sprovues i Kosovës	3	45	/	/

Policia e Kosovës


Për vitin 2025 janë planifikuara 22 trajnime me gjithsejtë 1279 pjesëmarrës, kurse janë realizuar 66 trajnime me 1698 pjesëmarrës që nënkupton se ka tejkaluar tri herë atë të planifikuara me një vlerësim prej 86.14 % të nivelit të kënaqshmërisë.

POLICIA E KOSOVËS					
Emri i trajnimit	Numri i trajnimeve të realizuara	Numri i vijuesve	Kohëzgjatja e trajnimit	Mesatarja e kënaqshmërisë	Nota mesatare
Trajnimet nga fusha e trafikut					
Trajnimi Ngasja Emergjente	38	496	5	91.08%	4.55
Trajnimi Ngasja Emergjente me Mjete të Blinduara	1	11	5		
Trajnimi Menaxhimi i Trafikut dhe Hetimi i Aksidenteve	1	26	19	85.6%	4.28
Trajnimi për Laser dhe Alkotest	1	20	2	75.4%	3.77
Trajnimi për Skuter	2	15	21	91.5%	4.57
Trajnimet nga fusha e hetimeve					
Trajnimi Krimteknikët e Vendit të Ngjarjes	2	43	30	66.15%	3.3
Trajnimi Themelor i Hetimit të Krimit	2	55	18	68.65%	3.43
Trajnimi Qendrat e Ndalimit	3	53	5		
Trajnimi i Avancuar për Hetimin e Krimit	1	20	15	53.1%	2.66
Trajnimi Hetimi i Dhunës Familjare	1	21	5	70.5%	3.52
Trajnimi Hetimi i Trafikimit të Drogës	1	20		91.5%	4.57
Trajnimet nga fusha e armëve të zjarrit					
Trajnimi për Trajner të Armëve të Zjarrit	1	23	17	86.8%	4.34
Trajnimet nga fusha e përgjithshme e policisë					

Trajnimi Themelor Zyrtar Policor (Gjenerata e 61-të)	1	462	62	87.9%	4.39
Trajnimi Themelor Zyrtar Policor (Gjenerata e 62-të)	1	279	65	87.7%	4.38
Trajnimet nga fusha e njësive të specializuara					
Trajnimi për Mbrojtje të Afërt	1	15	60	98.4%	4.92
Trajnimet nga fusha e menaxhmentit					
Kursi Plani Operativ	1	17	5	86.3%	4.31
Trajnimet nga njësia e Taktikave Mbrojtëse dhe Aftësive Fizike					
Kursi Instruktor i Taktikave Mbrojtëse dhe Ushtrimeve Fizike	1	27	50	82.8%	4.14
Trajnimet e Trajnerëve					
Programi për Aftësimin e Instruktorëve	1	20	19	76.7%	3.83
Trajnimet e policisë kufitare					
Trajnimi Bazik i Policisë Kufitare - FRONTEX	1	18	20	85.1%	4.26
Divizioni i Trajtimeve në Prishtinë					
Trajnimi Burimet e Fshehta Njerëzore të Inteligjencës	1	12	10	DSC nuk ka qasje në vlerësim	
Microsoft Excel për Operacione	1	10	4	DSC nuk ka qasje në vlerësim	
Trajnimi Analiza e Inteligjencës dhe Teknikat Analitike të Strukturuar	1	11	5	DSC nuk ka qasje në vlerësim	
Divizioni i Trajtimeve në bashkëpunim me SEESAC					
Trajnimi Luftimi i Basteve dhe Lojërave të Fatit të Paligjshme Online	1	18	5	77.3%	3.87

Zbërthimi i trajnimeve si në vijim:

- 66 trajnime në total,
- 1698 vijues në total,
- 86.14 % mesatarja e kënaqshmërisë, ose
- 4.30 nota mesatare.



Trajnimet për Policinë e Kosovës sipas fushave të përcaktuara në kuadër të Planit të Trajtimeve për vitin 2025.

Të gjeturat: programet trajnuese për Policinë e Kosovës janë zhvilluar dhe implementuar sipas kërkesës së policisë përfshirë edhe mbështetjen e trajnimeve jashtë planifikimeve të deklaruara në planin vjetor të trajnimeve. Nga totali i vlerësimeve neve kemi këto të gjetura si në vijim:

Trajnimet nga fusha e trafikut përbejnë 65.1 % të të gjitha trajnimeve për Policinë e Kosovës që janë zhvilluar në kuadër të kampusit të Akademisë me një mesatare të kënaqshmërisë prej 85.9 % ose me 4.29 notë mesatare, me gjithsejtë 568 vijues në trajnimet e trafikut.

Trajnimet e zhvilluara të trafikut janë kryesisht trajnime të shkurtra dhe të cilat në vetë ngërthejnë kryesisht pjesën praktike. Përdorimi i poligonit të vozitjes në kampus është esencial për zhvillimin e trajnimeve të kësaj fushe. Në kuadër të komenteve është regjistruar nevoja për vendosjen e rrethojave të poligonit të vozitjes duke e bërë ndarjen me pjesën e dedikuar për parking të automjeteve në kampus. Të gjitha fushat tjera të vlerësuara kanë një vlerësim që tejkalojnë të priturat andaj kërkohet vazhdimësi e rezultateve të arritura, fal punës së instruktorëve të trafikut. Po ashtu vlen të theksohet se instruktorët nga fusha e trafikut kanë qenë në formë intensive të angazhuar edhe në trajnimet profesionale në modulën e trafikut ose në kuadër të moduleve tjera apo rutinave të parapara në kuadër të trajnimeve të zhvilluara në kampus gjatë vitit 2025.

Rekomandim: të bëhet rishikim periodik i trajnimeve nga fusha e trafikut duke përdorur taksonominë e Bloomit. Të planifikohet ndarja fizike e poligonit të vozitjes nga parkingu i automjeteve si dhe të pasurohen e të mirëmbahen pajisjet trajnuese, me theks të veçant funksionalizimi i pajisjes rrëshqitëse “Skid Car”. Në anën tjetër të planifikohet mundësia e avancimit të mjeteve të përdorura në trajnimet e trafikut duke funksionalizuar qytezën simulative në kampus.

Trajnimet nga fusha e hetimeve përbejnë 15.0 % të të gjitha trajnimeve për Policinë e Kosovës që janë zhvilluar në kuadër të kampusit të Akademisë me një arritshmërisë të nivelit të kënaqshmërisë prej 69.9 % ose 3.5 notë mesatare me gjithsejtë 212 vijues në trajnime. Në kuadër të komenteve është regjistruar nevoja për pasurimin e dhomave simulative që përdoren për këtë fushë të trajnimeve duke përfshirë edhe laboratorin për trajnimet me gjurmë latente. Po ashtu vlen të theksohet se instruktorët e hetimeve kanë qenë në formë intensive të angazhuar edhe në trajnimet profesionale në modulën e hetimit ose në kuadër të moduleve tjera apo rutinave të parapara në kuadër të trajnimeve profesionale të zhvilluara në kampus gjatë vitit 2025

Rekomandim: rekomandojmë që Akademia në kuadër të kampusit të saj të rrisë nivelin e mjeteve lehtësuese dhe mbështetëse për zhvillimin e trajnimeve nga fusha e hetimeve duke avancuar dhomën simulative për zhvillimin e skenarëve të hetimit dhe laboratorin në kampus.

Trajnimet nga fusha e përgjithshme e policisë përbejnë 3.0 % të gjitha trajnimeve për Policinë e Kosovës që janë zhvilluar në kuadër të kampusit të Akademisë me një arritshmërisë të nivelit të kënaqshmërisë prej 87.8 % ose 4.39 notë mesatare. Vlerësimet e pranuar kanë treguar nevojën për rishikim të materialeve trajnuese sidomos tek faza e implementimit. Vlen të ceket që në kuadër të trajnimeve nga fusha e përgjithshme e policisë janë edhe “Trajnimet themelore– Zyrtar Policor” me gjithsejtë 741 kadetë përgjatë vitit 2025. Andaj ngarkesa e stafit të përcaktuar në trajnimet e përgjithshme përkundër përqindje së vogël në trajnime angazhimi i tyre në kohëzgjatje është regjistruar gjatë tërë vitit duke mos anashkaluar edhe asistimin që trajnerët tjerë nga fusha tjera ofrojnë në kuadër të trajnimeve profesionale në formë konstante.

Nga ana tjetër trajnimet që ofrojnë kompetencën për një profesion të caktuar, janë të bazuara në Standardet e Profesionit të aprovuara nga organet dhe instancat kompetente të MASHT-it, duke siguruar një kompetencë të plotë përmes trajnimeve të validuara dhe të ofruara nga një Institucion i akredituar për aftësimin dhe arsimimin profesional IAAP siq është Akademia. Dy trajnime të kësaj natyre e gjejmë të deklaruar si trajnim themelor në kuadër të kësaj fushe me kohëzgjatje prej 62 ditësh, në të cilin Akademia përjashtimisht aspektit mbështetës, nuk ka pasur qasje tjetër.

Rekomandim: të bëhet rishikim periodik i trajnimeve nga fusha e përgjithshme duke përdorur taksonominë e Bloomit. Rekomandojmë që Akademia të zbatojë në tërësi mandatin e saj në planifikim, menaxhim dhe implementim të trajnimeve në kampusin e saj, dhe në përputhje me mandatet që autoritetet rregullative të fushës së arsimit dhe aftësimin, i kanë ofruar dhe e kanë cilësuar në fushën vendore dhe atë ndërkombëtare përmes njohjes institucionale e programe.

Trajnimet nga fusha e standardeve dhe trajnimeve për trajner: përbejnë 1.5 % të gjitha trajnimeve për Policinë e Kosovës që janë zhvilluar në kuadër të kampusit të Akademisë me një arritshmërisë të nivelit të kënaqshmërisë prej 76.7 % ose 3.8 notë mesatare me gjithsejtë 50 vijues në trajnime.

Rekomandim: bazuar në të gjeturat tona dhe shqyrtimit të pjesës së pasqyrës së programit, shprehet nevoja për implementimin e taksonomisë së Bloomit, harmonizimin e materialit trajnues, prezantimeve të instruktorëve dhe doracakut të pjesëmarrësve.

Trajnimet nga fusha e menaxhmentit përbejnë 1.5 % të gjitha trajnimeve për Policinë e Kosovës që janë zhvilluar në kuadër të kampusit të Akademisë me një arritshmërisë të nivelit të kënaqshmërisë prej 86.3 % ose 4.31 notë mesatare me gjithsejtë 5 vijues në trajnime.

Rekomandim: ky trajnim nuk është i kategorizuar si duhet dhe mungon periudha e rishikimit andaj rekomandojmë një plan të veprimit për rishikim të materialit sipas taksonomisë së Bloomit. Në kuadër të komenteve kemi pranuar njohje për punën e instruktorëve nevojën për mbështetje me materiale trajnuese në zhvillimin e trajnimit.

Trajnimet nga fusha e taktikave mbrojtëse dhe aftësive fizike përbejnë 1.5 % të gjitha trajnimeve për Policinë e Kosovës që janë zhvilluar në kuadër të kampusit të Akademisë, meqë kurset/trajnimet e ricertifikimit nuk i nënshtrohen fazës testuese, ato edhe nuk vlerësohen. Mesataraje a rritur 82.8% ose notë mesatare e kënaqshmërisë 4.14.

Rekomandim: plotësimi urgjent i kushteve logjistike të hapësirave trajnuese në kampus. Pjesa e ushtrimeve fizike-pajisjet përcjellëse, nga ato të ushtrimeve fizike e gjerë tek shtresat për ushtrime dhe praktika të fizikut. Ndarjen e veqant për qëndrimin ditor të stafit mësimdhënës dhe kujdestar në orët shtës të mësimi.

Trajnimet nga fusha e policisë kufitare përbejnë 1.5 % të gjitha trajnimeve për Policinë e Kosovës që janë zhvilluar në kuadër të kampusit të Akademisë, mesataraje a rritur 85.1% ose notë mesatare e kënaqshmërisë 4.26.

Rekomandim: nevojitet plotësimi i kushteve në aspektin e pajisjes nga fusha e ngushtë kufitare qoftë ajo e sistemit harduerik apo softuerik.

Shërbimi Korrektues i Kosovës

Për vitin 2025 janë planifikuar 16 trajnime me gjithsejtë 300 pjesëmarrës, kurse janë realizuar 7 brenda kampusit dhe 1 trajnim jashtë kampusit të akademisë me gjithsejtë 165 pjesëmarrës, me një vlerësim të lartë prej 95.01% të nivelit të kënaqshmërisë ose me një notë mesatare prej 4.31.

Po ashtu me datë 30.09.2024 ka filluar edhe Trajnimi Profesional Zyrtar Korrektues (Gjenerata e 45-të) me gjithsejtë 111 kadetë të cilët kanë diplomuar në vitin 2025 dhe do paraqiten si pjesë e raportit vjetor të vlerësimit për vitin 2025.

SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS					
Emri i trajnimit	Numri i trajnimeve të realizuara	Numri i vijuesve	Kohëzgjatja e trajnimit	Mesatarja e kënaqshmërisë	Nota mesatare
Trajnimi Profesional Zyrtar Korrektues (Gjenerata e 45-të)	1	111	81	96.6%	4.8
Trajnimi Profesional Zyrtar Korrektues (Gjenerata e 45-të, vazhdimi i trajnimit)	1	1	81	96.6%	4.8
Trajnimi Profesional Zyrtar Korrektues (Gjenerata e 45.1, fillimi i trajnimit me vonesë)	1	2	81	96.6%	4.8
Trajnimi Vlerësimi i Rrezikut dhe Nevojave për Recidivizëm	2	20	5	93.1%	4.65
Trajnimi Intervista Motivuese	1	16	3	93.4%	4.67
Trajnimi Menaxhimi i Zemërimit	1	15	5	96.3%	4.81
Trajnimet e realizuara jashtë kampusit të Akademisë					
Trajnimi Themelor për Pistoletën Glock 9x19 (SHKK)	1	16	5	93.0%	4.65

Zbërthimi i trajnimeve si në vijim:

- 8 trajnime në total, ku prej tyre 1 trajnim është realizuar jashtë kampusit të Akademisë,
- 181 vijues në total,
- 95.0% % mesatarja e kënaqshmërisë, ose
- 4.75 nota mesatare.

Përfundimisht trajnimeve në kampus, Akademia ka mbështetur edhe trajnimin jashtë kampusit gjegjësisht në Qendrën Korrektuese në Dubravë.

Ne kuadër të trajnimeve për Shërbimin Korrektues të Kosovës është realizuar edhe trajnimi profesional Gjenerata e 45 “Zyrtar korrektues” me gjithsejtë 111 kadetë për një periudhë kohore prej 7 muajsh sipas vendimit të KD të AKK mbi akreditimin e Akademisë si IAAP me trajnim të validuar.

Vlerësimet e pranura kanë treguar nevojën për rishikim të materialeve trajnuese dhe të materialit mësimor në menaxhim dhe shpërndarje.

Të gjeturat DSC ka vlerësuar edhe pasqyrat e trajnimeve dhe ka gjetur se mungon taksonomia e Bloomit (*përrjashtimisht trajnimit profesional*), trajnimet tjera duhet rishikuar në formë sistematike.

Rekomandim: plani i ANT-së për trajnimin profesional të jetë i koordinuar me Akademinë dhe në rivalidimin e radhës së trajnimit profesional të rishikohet programi pjesët e identifikuara si nevojë për ndryshim. Po ashtu rekomandojmë që të digjitalizohet sistemi i të dhënave dhe listave në SHKK duke i ofruar Akademisë informatë më të shpejtë rreth kadetëve dhe përmbushjes së obligimeve ndaj AKK si deklarimi i stafit dhe i pjesëmarrësve në trajnim, e cila për këtë gjeneratë ka qenë pak e vonuar. Trajnimet tjera të deklaruara në kuadër të planit vjetor të trajnimeve të jenë trajnime të realizuara dhe të mos kemi persëritje në mos-realizimin e trajnimeve dhe planit të ANT-së. Trajnimet e realizuara jashtë kampusit të Akademisë janë trajnime me realizim të lartë përkundër faktit që preferohet që të bëhet ndaraj në mes të trajnimeve me kompetencë dhe atyre gjatë shërbimit të cilat do mund të realizoheshin në ISP-te respektive.

[Shërbimi Sprovues i Kosovës](#)

Për vitin 2025 janë planifikuar 3 trajnime me gjithsejtë 45 pjesëmarrës dhe si rrjedhojë e strategjive të SHSK-së, nuk është realizuar asnjë nga trajnimet e planifikuara dhe të deklaruar në punëtorinë e planit vjetor të trajnimeve në Akademi.

[Inspektorati Policor i Kosovës](#)

Për vitin 2025 janë planifikuar të mbahen 4 trajnime me gjithsejtë 60 pjesëmarrës, dhe si rrjedhojë e strategjive të IPK-së, nuk është realizuar asnjë nga trajnimet e planifikuara dhe të deklaruar në punëtorinë e planit vjetor të trajnimeve në Akademi.

Dogana e Kosovës

Për vitin 2025 janë planifikuar 10 trajnime me gjithsejtë 198 pjesëmarrës dhe janë realizuar 7 trajnime me gjithsejtë 176 pjesëmarrës ose 70.0% të trajnimeve të planifikuara me një mestrarë të trajnimeve të vlerësuara prej 83.0% ose notë mesatare prej 4.15 të nivelit të kënaqshmërisë (nga totali i trajnimeve të realizuara, 4 nga këto trajnime kanë qenë trajnime të ricertifikimit – të cilat i takojnë trajnimeve që ofrohen gjatë shërbimit dhe nuk janë trajnime të kompetencës profesionale të testuar andaj edhe nuk i nënshtrohet vlerësimit).

DOGANA E KOSOVËS					
Emri i trajnimit	Numri i trajnimeve të realizuara	Numri i vijuesve	Kohëzgjatja e trajnimit	Mesatarja e kënaqshmërisë	Nota mesatare
Ricertifikimi Kursi Bazik për Arrest dhe Ndalim	4	39	3 ditë	Kursët/trajnimet e ricertifikimit nuk i nënshtrohen fazës testuese andaj edhe nuk vlerësohen	
Trajnimi Profesional Zyrtar Doganor Numër 01/2025	1	57	62	89.0%	4.4
Trajnimi Profesional Zyrtar Doganor, Numër 02/2025	1	51	62	84.6%	4.2
Ndryshimet e Pësuara me Kodin e Ri Doganor	1	29	3	75.4%	3.77

Zbërthimi i trajnimeve si në vijim:

- 7 trajnime në total (të realizuara në kampus),
- 176 vijues në total,

Agjencia e Menaxhimit Emergjent

Për vitin 2025 janë planifikuar 17 trajnime me gjithsejtë 412 pjesëmarrës, kurse janë realizuar 9 trajnime me gjithsejtë 149 pjesëmarrës ose ka realizuar 53 % e trajnimeve të planifikuara, bazuar në kërkesat dhe strategjitë e AME-së dhe atë me një mesatare të kënaqshmërisë prej 94.23 % ose 4.71 nota mesatare.

AGJENCIA PËR MENAXHIM TË EMERGJENCAVE					
Emri i trajnimit	Numri i trajnimeve të realizuara	Numri i vijuesve	Kohëzgjatja e trajnimit	Mesatarja e kënaqshmërisë	Nota mesatare
Trajnimi Përdorimi i Mjeteve Themelore për Shuarjen e Zjarrit	1	11	2	99.25	4.96
Trajnimi Bazat e Menaxhimit Emergjent	1	21	5	78.4%	3.92
Trajnimi Bazik në Zjarrfikje dhe Shpëtim	1	50	10	91.9%	4.60
Kursi Vlerësimi i Rreziqeve	1	10	3	90.1%	4.51
Trajnimi Zvogëlimi i Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera	1	12	2	94.1%	4.70
Trajnimi Aksidentet e Komunikacionit Rrugorë	1	11	5	91.75	4.58
Trajnimi Materiet e Rezikshme	1	9	4	90.1%	4.50
Trajnimi Bazik i Forumeve të Sigurisë për Reagim Emergjent	2	25	5	95.9%	4.79

Zbërthimi i trajnimeve si në vijim:

- 9 trajnime në total,
- 149 vijues në total,
- 91.4 % mesatarja e kënaqshmërisë, ose
- 4.57 nota mesatare.

Të gjeturat: mungesë në rishikimin sistematik të trajnimeve, mungesën taksonominë Bloomit. Po ashtu ka ngecje në implementimin dhe planifikim të trajnimeit profesional si pasojë e mbështetjes infrastrukturore të pjesës praktike të trajnimit. Vlen të theksohet fakti që AME ka arritur të realizoj trajnimin profesional për herë të parë në Akademi dhe i cili pritet të përmbyllet në fillimin e vitit 2026, duke i hapur rrugën trajnimeve të radhës.

Rekomandim: të bëhet rishikimi i trajnimeve me qëllim pasqyra trajnuese nuk përkon me nivelin dhe taksonominë e Bloomit. Të bëhet harmonizimi i ANT dhe mundësive të realizimit të trajnimeve. Akademia të investoj në zhvillimin e hapësirave shtesë trajnuese që ndërlidhen me zjarrfikje, sidomos ato që ndërlidhen edhe me realizimin e trajnimit profesional, e cila gjere me tani në mungesë të poligonit për zjarrfikje ka qenë pothuajse i pamundur të realizohet.

Të gjeturat sipas trajnimeve të ofruara nga Partnerët Ndërkombëtar

Akademia në kuadër të partneritetit të saj të ngushtë ndërkombëtar në fushën e trajnimit, gëzon një mori mundësish të cilat i realizon përmes marrveshjeve të bashkëpunimit të ndërsjelltë në arenën ndërkombëtare. Përfundimisht marrëveshjeve, në suazat vjetore të planifikimit të trajnimeve, Akademia që nga themelimi i saj, rol të veçantë i ofron partnerëve të saj të ngushtë si:

- ICITAP, dhe
- OSBE

në prezantimin e mundësive, që ata i ofrojnë përmes programeve trajnuese dhe të cilat programe i implementojnë në Akademi për fushën e sigurisë publike në përgjithësi.

ICITAP

Për vitin 2025 ICITAP në kuadër të planit vjetor të trajnimeve në Akademi, ICITAP nuk ka planifikuar trajnime.

OSBE

Për vitin 2025 OSBE ka planifikuar të ofroj 6 trajnime me gjithsejt 110 pjesëmarrës/vijues, kurse ka realizuar 4 trajnime me gjithsejt 90 pjesëmarrës, ose 66.6% trajnime të realizuara nga totali i planifikuar (*DSC qasje vlerësim ka pas vetëm në 2 prej tyre*).

OSBE					
Emri i trajnimit	Numri i trajnimeve të realizuara	Numri i vijuesve	Kohëzgjatja e trajnimit	Mesatarja e kënaqshmërisë	Nota mesatare
Trajnimi për Hetimet e Brendshme për Policinë e Kosovës	1	19	5	86.0%	4.30
Trajnimi Luftimi i Krimit Mjedisor	1	20	2	DSC nuk pas qasje në vlerësim	
Trajnimi i Trajnerëve mbi De-eskalimin dhe Komunikimin e Ndjeshëm Gjinnor	1	30	2	DSC nuk pas qasje në vlerësim	
Trajnimi për Trajnerë Instruktorë të Armëve të Zjarrit	1	21	10	86.8%	4.34

Zbërthimi i trajnimeve si në vijim:

- 4 trajnime në total,
- 90 vijues në total,
- 86.4 % mesatarja e kënaqshmërisë, ose
- 4.32 nota mesatare.

Nga këto 4 trajnime të realizuara, dy nga këto DSC nuk ka pasur qasje në vlerësim.

Të gjeturat: trajnimet e ofruara nga OSBE janë trajnime të ofrohet për ISP dhe kryesisht trajnime me ekspertë të fushës së ngushtë.

Rekomandim: trajnimet të kategorizohen në kuadër të kategorizimeve në Akademi në përputhje me Udhëzim Administrativ nr. 01/2012 - AKSP për trajnime dhe zhvillimin e kurrikulave, dhe po ashtu të jenë në përputhje me taksonominë e Bloomit.

Trajnimet e përbashkëta

Për vitin 2025 Akademia ka planifikuar të ofroj 13 trajnime me gjithsejt 260 pjesëmarrës, kurse ka realizuar 14 trajnime me gjithsejt 278 pjesëmarrës ose ka realizuar tejkaluar planifikimet, me një vlerësim mesatar prej 89.73% të nivelit të kënaqshmërisë ose me një notë mesatare prej 4.48.

TRAJNIMET E PËRBASHKËTA					
Emri i trajnimit	Numri i trajnimeve të realizuara	Numri i vijuesve	Kohëzgjatja e trajnimit	Mesatarja e kënaqshmërisë	Nota mesatare
Menaxhimi i Vijës së Parë	1	17	29	91.0%	4.55
Sjellja me Njerëz dhe Detyrat në Vendin e Punës	1	10	5	88.2%	4.41
Trajnimi të Drejtat e Njeriut	1	15	1	86.4%	4.32
Trajnimi Elementet Bazë të Menaxhimit	1	21	5	91.3%	4.57
Trajnimi Mbrojtja e të Dhënave Personale	1	21	1	DSC nuk ka pas qasje në vlerësim	
Trajnimi Ndërgjegjësimi, Parandalimi dhe Luftimi i Korrupsionit	1	21	5	89.6%	4.48
Kursi Menaxhimi i Aksidenteve Radiologjike dhe Zbulimi i Kontrabandës së Materialeve Radioaktive dhe Bërthamore	1	7	3	86.2%	4.31
Trajnimi për Zyrtarët e Sigurimit	4	91	5	95.4%	4.7
Trajnimi Barazia Gjinore	1	22	1	DSC nuk ka pas qasje në vlerësim	
Trajnimi Ngacmimet Seksuale në Vendet e Punës	1	23	1	DSC nuk ka pas qasje në vlerësim	
Trajnimi Etika në Vendin e Punës	1	30	1	DSC nuk ka pas qasje në vlerësim	

Zbërthimi i trajnimeve si në vijim:

- 14 trajnime në total,
- 278 vijues në total,
- 89.7 % mesatarja e kënaqshmërisë, ose
- 4.4 nota mesatare.

Nga 14 trajnime të realizuara, 4 nga këto DSC nuk ka pasur qasje në vlerësim

Të gjeturat: trajnimet e përbashkëta janë një grup trajnimesh që realizohen nga Akademia në bashkëpunim me Institucione tjera jashtë ISP-ve. Në fakt këto trajnime ofrohen për ISP dhe palët e interesit në ngritjen dhe avancimin e njohurive të veqanta dhe specifike. Nga informatat kthyesë të pranuar vlen të ceket se shumica e këtyre trajnimeve janë të pakategorizuara andaj kërkoj që të standardizohen si trajnime dhe të kenë të implementuar në zhvillimin e tyre Taksonominë e Bloom-it. Në aspektin infrastruktururo disa nga trajnimet e realizuara kanë treguar nevojën urgjente për funksionalizimn e dhomës së Webinarit. Përkundër kërkesave të identifikuara dhe të deklaruara, Akademia ka edhe një plan shtesë të zhvillimit të stafit të saj përmes trajnimeve të cilat nuk inkuadrohen në kuadër të planit vjetor të trajnimeve.

Rekomandim: të bëhet rishikimi i trajnimeve meqë pasqyra trajnuese nuk përkon me nivelin dhe taksonominë e Bloomit. Nevojitet një planifikim i mirëfilltë i trajnimeve dhe kjo të inkorporohet në kuadër të trajnimeve sipas kategorive, meqë të gjitha trajnimet e prezantuara në planin vjetor të trajnimeve janë pjesë e vetë akademisë. Ndoshta do duhej të mendohej për pasurimin e planit të trajnimeve duke prezantuar edhe trajnimet që ofrohen përmes marrveshjeve të bashkëpunimit me organizata ndërkombëtare si CEPOL etj.

Rekomandohet po ashtu që Akademia të ngrisë nivelin e saj të zhvillimit të kurrikulave sipas nevojave të ISP-ve dhe të kaloj nga aspekti teknik në atë zhvillimor, meqë posedon profesionist të fushës. Akademia në kuadër të organogramit të saj ka Departamentin e trajnimeve dhe përkrahjes arsimore me divizionet përbërëse të saj nga fusha e trajnimeve, por se mbetet ende i dëshiruar roli aktiv i saj në fushën e trajnimeve sidomos në menaxhimin e atyre për të cilat është e akredituar me mandatë.

Komentet e përmbledhura

Vijuesit në trajnimet e realizuara në Akademi dhe jashtë kampusit në pjesën e dedikuar për komente kanë shfaqur sinqeritet dhe kanë ofruar propozimet e tyre të cilat ndërlidhen me procesin dhe ngritjen e tyre profesionale në fushat e caktuara të sigurisë publike. Në përgjithësi kemi pranuar komente pozitive për gjithë procesin e trajnimeve, ushtrimeve dhe aktiviteteve në Akademi dhe po ashtu pjesëmarrësit/kadetët kanë vlerësuar gjithë procesin e zhvillimit të trajnimeve nga mësimnxënija, materiali mësimor, ligjeruesit/mësimdhënësit dhe instruktorët, infrastrukturën ndihmëse dhe përcjellëse si dhe shërbimet mbështetëse të ofruara në kampus.

Ata kanë inkurajuar Akademinë në investimin e fushës së trajnimeve sidomos në sistematizimin e trajnimeve në aspektin e rishikimit të materialeve trajnuese duke qëndruar në hap me ndryshimet e reja. Pjesëmarrësit kanë deklaruar mbi përkushtimin e mësimdhënësve/instruktorëve duke ofruar interaktivitet gjatë trajnimit dhe duke vlerësuar çdo mendim. Në fakt pjesa e komenteve janë të gjeneralizuara në njohjen dhe paraqitjen profesionale të dëshmuar të mësimdhënësve/instruktorëve në Akademi.

Mbetet ende e dëshiruar reflektimi i Akademisë në investimin e saj në rregullimin e disa fushave trajnuese si ajo e poligoneve apo edhe e mbështetjes logjistike në disa raste të evidentuara.

Në total kemi pranuar dhe analizuar 92030 komente.

Rekomandimet e përmbledhura

Divizioni për sigurimin e cilësisë në Akademi, pasi që ka shqyrtuar përgjigjet e pjesëmarrësve në trajnimet e realizuara përgjatë vitit 2025 dhe pas analizës së të gjitha pyetjeve dhe komenteve, në këtë fazë të zhvillimit të institucionit, i rekomandon menaxhmentit të lartë të Akademisë që të merren hapat si më poshtë:

- Akademia në fazën e planifikimeve të trajnimeve profesionale të optimalizojë realizimin e trajnimeve profesionale me numër më të vogël dhe të shpërndarë përgjatë vitit duke ofruar mundësinë e zhvillimit përgjatë tërë vitit.
- Të implementohen trajnimet profesionale në përputhje me validimin e tyre në kohështirje dhe në kompetencë të plotë me të gjitha elementet e tyre përbërëse si IAAP.
- Të digjitalizohet sistemi i të dhënave dhe listave në trajnimet profesionale duke i ofruar Akademisë informatë më të shpejtë rreth kadetëve dhe përmbushjes së obligimeve ndaj AKK si deklarimi i stafit dhe i pjesëmarrësve në trajnim, me theks të veçantë kontratat e stafit trajnues me IAAP-në.
- Trajnimet gjatë rishikimit apo edhe zhvillimit të trajnimeve të reja, të marrin për bazë implementimin e taksonomisë së Bloom-it sipas foljeve vepruese në kuadër të nivelit të kualifikimeve me çka definojnë qartë se cilat folje duhet përdorur për llojin e trajnimeve gjegjëse;
- Të rishikohet urgjentisht Udhëzim Administrativ nr. 01/2012 - AKSP për trajnime dhe zhvillimin e kurrikulave;
- Të rritet numri i bashkëpunimeve dhe marrëveshjeve me IAAP vendore dhe ndërkombëtare për të mundësuar mobilitet të kadetëve;
- Të pasqyrohen të gjitha aktivitetet në web-faqe, e cila në fushën e trajnimeve është e zbrazët;
- Akademia të rrisë nivelin e pjesëve ndihmëse infrastrukturore për zhvillimin e trajnimeve në aspektin praktik si poligonet e armëve të zjarrit, zjarrfikjes, poligoni i vozitjes dhe pjesët tjera si laborator, dhoma simulative, FATS.
- Të planifikohet mundësia e avancimit të mjeteve të përdorura në trajnimet e trafikut duke funksionalizuar qytezën simulative në kampus;
- Të bëhet ndarja e trajnimeve me kompetencë dhe trajnimeve që ofrohen gjatë shërbimit të cilat do mund të zhvilloheshin në kuadër të ISP-ve respektive;
- Të bëhet harmonizimi i ANT-së dhe mundësive në realizimin e trajnimeve sipas planit vjetor të trajnimeve;
- Të jetësohet mandati i trajnimeve në kuadër të Akademisë me të gjitha pjesët përberëse të saj duke filluar nga analiza e nevojave për trajnim, planifikim dhe organizim të trajnimeve, zhvillim të kurrikulave e gjere tek shërbimet jashtë-kurrikulare të cilat për momentin mungojnë;

Foljet aktive themelore të zhvillimit të trajnimit sipas taksonomisë së Bloom-it

Njohja		Të kuptuarit		Të zbatuarit		Analiza		Sinteza		Vlerësimi / krijimi	
		Niveli 3		Niveli 4 & 5		Niveli 6					
		Trajnimi Themelor		Trajnimi i Avancuar		Trajnimi i Specializuar		Trajner per trajner			
Define, Identify, Describe, Recognize, Tell, Memorize, Quote, State, Match, Recognize, Select, Examine, Locate, Recall, Enumerate, List, Copy, Tabulate, Duplicate, Discover,	Përcakton, Identifikon, Përshkruan, Njeh, Tregon, Mban mend, Citim, Shteti, Pershtat Njohn, Zgjidh, Ekzaminon, Gjen, Kujtoj, Numëro, Listë, Kopjo, Nderlidh, Dublikon, Zbulon,	Summarize, Interpret, Classify, Compare, Contrast, Infer, Relate, Paraphrase, Cite, Discuss, Extend, Predict, Indicate, Translate, Associate, Explore Convert Express, Differentiate,	Përmbledh, Interpreton, Klasifikon, Krahason, Kontrast, Konkludon, Lidh, Parafrazon, Citon, Diskuton, Dallon, Zgjeron, Parashikon, Tregon, Përkthe, Bashkëpunëtor, Eksploron Konverton Shpreh, Diferencon,	Solve, Change, Relate, Complete, Use, Sketch, Discover, Show, Demonstrate, Dramatize, Produce, Prepare, Manipulate, Apply, Illustrate, Choose, Interpret, Experiment, Modify, Construct,	Zgjidh, Ndryshon, Nderidh, Ploteson, Përdor, Skicon, Zbulon, Shfaq, Demonstron, Të dramatizon, Prodhon, Përgatit, Manipulon, Aplikon, Ilustron, Zgjidhni, Interpreton, Eksperimenton, Modifikon, Ndërton,	Contrast, Connect, Classify, Distinguish, Infer, Order, Separate, Point-out Survey, Subdivide, Appraise, Break Down, Divide, Advertise, Categorize, Prioritize, Differentiate, Select, Explain, Analyze,	Ben kontrast, Lidh, Klasifikon, Të dallojë, Konkludoj, Porosit, Ndan, thekson Anketon, Nënndan, Vlerëson, Zbërthen, Ndan, Reklamon, Kategorizon, Prioritetizon, Diferencon, Zgjidh, Shpjegon, Analizon,	Criticize, Defend, Appraise, Evaluate, Judge, Support, Compare, Decide, Recommend, Summarize, Access, Choose, Convince, Defend, Estimate, Find errors, Grade, Measure, Predict, Rank,	Kritikon, Mbron, Vlerëson, Vlerësoni, Gjykon, Mbështet, Krahason, Vendos, Rekomandon, Përmbledh, Qaset Zgjidh, Bind, Mbron, Përafron, Gjen gabime, Gradon, Matë, Parashikon, Rendit,	Design, Modify, Role-Play, Develop, Rewrite, Pivot, Modify, Collaborate, Invent, Write, Re-write, Formulate, Imagine, Generalize, Integrate, Plan, Hypothesize, Substitute, Constructs,	Dizajnon, Ndryshon, Luan rol, Zhvillon, Rishkruan, Pivot, Modifikon, Bashkëpunoni, Shpik, Shkruan, Rishkruan, Formulon, Imagjinon, Përgjithëson, Integron, Planifikon, Hipotetizon Zëvendëson Ndërton